

Vlera e njeriut nuk qëndron  
në dijen, por në  
vullnetin e fortë  
**HERBART.**

# Normalisti

## Mbrendija

Edukata Përparimtare.  
Psikologjia e mëndërisë.  
Ç' është Edukata e Re ?  
Përkëthimet Pedagogjike.  
Larg rregullave formale me natyrë ushtarake.  
Randësija e lojës n' edukatën fizike të fëmijet. II.  
Provë Mësimi.  
Provë Mësimi.  
Ditari i një Arësimtari.  
Trashëgimi.  
Varfanjaku ( vjershë ).  
Në vorr të nanës ( vjershë ).  
Nëpër Revistat.  
Folklori.  
Shënimet e Redaksisë.

# Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkëncore  
DEL NJI HERË NË MUAJ.

E botojnë nxânësit e Normales

Editor : Harilla Kuçuli '37.  
Sekretar . Kol Lekaj '37.  
Arkëtar : Jovan Gjerga '37.

## Ndihmësit

Tajar Reovica '38.  
Panajot Foto '38.  
Koço Mosko '39.

## Drejtimi

E përkohëshmja "NORMALISTI,"  
Shkolla Normale  
Elbasan

Dorëshkrimet nuk kthehen.

## Pajtimet :

Për mësues  
Copa lek 1.25  
Për gjithë vitin fr. ar. 1.50

Për nxânës  
Copa lek 1.  
Për gjithë vitin fr. ar. 1.

# NORMALISTI

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore

DEL MUAJ PËR MUAJ

E botojnë nxânësit e Normales.

VITI I VIII.

— PRILL 1937 —

Nr. 5

## Edukata Përparimtare

Në veprat pedagogjike të paka janë ato terma që kanë qëndrueshmëri të mos-kuptuara ose të interpretuara me ngjyra të ndryshme se sa fraza "Edukata progresive". Ehtë pra shumë rëndë të bëhet një përkufizim i qartë për një shkollë përparimtare. Kjo errësirë rrjeth nga fakti se shvillimet e edukatës progresive kanë marrë pamje edukative të ndryshme sipas mendimeve të shumta që janë çfaqur. Jo vetëm që shumë edukatorë janë marrë me fazat e ndryshme të këtij problemi, por edhe disa nga ata i kanë shqyrtuar po ato probleme me fjalë dhe me mënyra të ndryshme. Nga ky shkak, në përshkrimin e edukatës përparimtare munt të përmendim vetëm ato karakteristika që janë vënë në praktikë në shkollat me të vërtetë përparimtare t' Evropës e t' Amerikës, dhe jo të marrim vetëm methodat e nja dy shkollave të cilat munt të jenë ultra progresive, por të cilat nuk munt të thuhet se përfaqësojnë shkollat e një shteti. Në këtë kupëtim edukata përparimtare është edukata e re në

kundërshtim me edukatën tradicionale e të vjetër.

Karakteristika e parë e edukatës përparimtare është pa dyshim zbulimi i natyrës së fëmijës. Studimet e gjata që janë bërë mbi fëmijën kanë tërhequr shumë edukatorë të kupëtojnë se organizimi, landa, dhe methodat e shkollave të vjetra nuk ishin në harmoni me natyrën dhe nevojat e fëmijëve në rritjen e tyre. Ky zbulim solli ndërrime të ndryshme n' errësimin praktik duke formuluar landën dhe methodën me një mënyrë që tu përshtatshin zotësive mendore dhe nevojave të individit, duke bërë mësimin ma të gjallë m' anën e vet-veprimit dhe të aktiviteve të dobishme, duke shvilluar konciencën e grupit dhe shpirtin kooperativ, dhe duke filluar të edukonin prindërit në përgjigjësit e tyre kundrejtë familjes dhe shkollës.

Pas këtyre vjen qëllimi i dytë i edukatës progresive; qëllimi që shkolli të fillojë me natyrën dhe eksperimentat e fëmijës, dhe jo të imponojë që përjashta landën dhe nivelin e je-

tës. Në qoftë se mësuesi fillon me ato brendi që fëmija di sot, nuk do të jetë shumë rëndë as për nxanësin të kupëtojë lëndën e re as për mësuesin që të hidhet nga e ditura në e pa ditura. Nga ana tjetër, po të paraqitin shkolla lëndë q'është jashtë natyrës së nxanësit ta përvetësojë dhe që s'ka lidhje me eksperiencën e jetës, ahëre mëndja e fëmijës do të revoltojë.

Bashkë me natyrën dhe eksperiencën e nxanësve edukata e re lith edhe informalitetin. Sikundër që fëmija ngrehin krye kundër një gjëje q'është jachtë fuqisë mendore të tyre. ashtu veprojnë ata edhe kur mësimi bëhet i njëshmë dita me ditën, java me javën, muaji me muajin. Varieteja u pëlqen të vegjëlve aqë shumë sa dhe të mbëdhenjve. Eksperienca e ka provuar se formalizmi është armik i veprimt mendor dhe i rritjes së ekspresionit emocional.

E katërta karakteristikë e kësaj edukate është rëndësia që u jepet çështjeve të rrënjosura e shoqërore, si lidhjet e ngushta ndërmes nxanësve me njëri jetrin dhe midis nxanësve dhe mësuesve. Me që marëdhëniet midis njerësve janë provuar të kenë

një vleftë të madhe edukative, izolimi i nxanësve nga mësuesi dhe i shkollës nga jeta është një gjë e panatyrëshme dhe dëmprurëse në veprimet arësimore.

Dhe më në funt, edukata përparimtare tregon një respekt të math për individin e fëmijës. Mëndja e fëmijës, thonë arësimitarët progresivë, s'është siç mendonte Locke një **tabula rasa**; çdo fëmijë është lindur me disa fuqi dhe instikte të cilat e bëjnë të mundur për atë të disiplinohet e të bëhet i moralshëm si për veten e tij ashtu edhe për shoqërimin. Kjo arësye i shtyn ata t'u japin fëmijëvet ma shumë liri se sa u japin shkollat tradicionale. Sa kohë që fëmija mësojnë vetëm kur veprojnë, ahëre natyrisht sa ma tepër të veprojnë, aq ma shumë do të mësojnë; dhe sa ma tepër liri të kenë, aq ma tepër do të veprojnë. Veç kësaj, liria i bën fëmijën të guxishëm; i shtyn ata të vetveprojnë dhe më në funt të kriojnë. Vetëm kur fëmija zë të nxier xheç nga vulneti dhe nisiativa e tij munt të thuhet se ay i hodi themelet për zotërimin e trupit e të mëndjes.

Dr. Stefan Treska

**Binduni se, vetëm duke e dhënë metodikisht e pa të meta edukatën për liri, do të rritni të qenme të lira.**

Znja Kergomard.

Claparède

Përkthim'

# Psikologjia e mendërisë.

Psikologjia e mendërisë nuk është studjuarë në një mënyrë aq të gjallë në veprat psikologjike<sup>1)</sup>; shumë psikologë janë marrë me këtë çështje, por me gjithë atë nuk na kanë dhënë një përgjigje fare të kthjellët për mbi elementet e ngjarjet që ndërhyjnë në punë të mendërisë ose në veprimin mendor. Prandaj m' u-duk i nevojshëm një studim empirik i të gjitha përshkesavet (processus) të mendërisë dhe më tepër në relacionet e tyre me jetën; dua të bënj pra një skicë të kuptimit të mendërisë, të fillë si na e paraqesin të dhënat e jetës.

**Methoda e studimit.**— Së pari, për të bërë një studim të kthjellët mbi mendërinë, duhet të lemë më një anë dy sistemet filosofike, që e kanë mbajtur mjaft kohë psikologjinë nën sundimin e idetvet të tyre; një nga këta sisteme është ai i zotësivët të shpirtit ( faculté de l'âme ), i cili e konsideron mendërinë si një zotësi kryesore, por të pa analizuarë; sistemi tjetër, ai i associationismit (shoqërimit) thotë se mendëria nuk është gjë tjetër veçse një ngjarje e thjeshtë e shoqërimevet të fituara. Të dy këta sisteme (nuk po zgjaten mbi analizën e tyre) nuk na i mbushin mendjen si duhet, mbassi s' janë të bazuarë mbi ngjarje praktike. Psikologjia e mendërisë duhet të marrë për bazë studimi, vetëm methodën eksperimentale, observationin dhe experiencën; vetëm me anën e një vëzhgimi të fillë mund të shpërthejmë e të kuptojmë më mirë punën e mendërisë dhe elementet e saj. Nga një anë, methoda gjenetike do të na mësonjë se si qëndron puna e mendërisë te primitivi, te femija e te kafsha; nga ana tjetër me hoda patologjike do të na japë njohni mbi mendërinë e imbecilit, etj; manded duhet bërë gjithashtu një studim i mendërisë së të madhit, në gjendje normale, duke përshtatur si mbas rasës s' expe-

rimentationin objektif ose introspeksionin; po ashtu studimi i individualitetit dhe i pjerrevet të ndryshme, do të na ndihmonjë në një mënyrë indirekte në punë të mendërisë.

Në këto kohët e fundit janë bërë mjaft studime për mbi mendërinë, si ato të Bine-it e të të tjerëve, por ato kanë përshkuarë më tepër hollësit e strukturës së mendërisë, kurse është më tepër nevojë për një plan të veprimevet mendore, d. m. th. për një skicë ku të dëfthen elementet e ndryshme për mbi të cilët mbështetet mendëria.

Në studimet e ndjekura rishtas në laboratorin psikologjik të Genevës kemi përdorur një methodë të re me emrin "methode de la réflexion parlée... si mbas kësaj methodë, subjekti a nxënësi p. sh., të cilit i jepet një problemë për të zgjidhur, duhet të kallzojë fund e krye se ç'ka ndodhë ndërgegjegen a vetëdijën e tij, heshtjet, dyshimet, idetë që i vinë në mendje; kështu pra do të kuptojmë me të vërtetë se ç'qëndresë mer mendja e subjektit, në zgjidhjen e kësaj probleme.

Këto pra do të jenë bazat t'ona për vëzhgimin e mendërisë; por përpara se t'i ryjmë këtij studimi, na duhet të dimë se ç' është mendëria.

**Përkufizimi i mendërisë** — Fiala mendëri është e përdorur në tre kuptime të ndryshme, të cilët po i paraqesim me radhë: 1.) Mendëria është emri i dhënë, klasës së ngjarjevet a fenomenevet psikike, që kanë për objekt njohnit, në këtë kuptim mendëria është e kundërta e jetës ndjenjore dhe mbiemri i saj në këtë rasë është i ditur. 2.) Mendëria është një mënyrë të qenuri të përshkesavet psikike, të cilat i përshtaten me sukses rrethanavet

<sup>1)</sup> Ky artikulli i Claparède-it është botuarë 1917, por studimet e tij mbi këtë çështje janë të vlershme.

a problemave të reja; mbiemni në këtë rast është i mënçur: Në qoftë se e konsiderojmë këtë mënyrë të qënuri, jo si një cilësi të thjeshtë, por si një zotësi, mund të themi pa ndalim se mendërija është zotësia e të zgjidhurit të problemave të reja me anë të të menduarit; në këtë kuptim mendërija është e kundërta e automatizmit, e instiktit, mbassi këta dy të fundit, nuk mund të na ndihmojnë kurrësesi në zgjidhjen e një probleme të re. 3.) Mëndëri, do të thotë, shpesh herë në gjuhë të popullit një zotësi të menduari përmbi mezatoren (la moyenne); d. m. th. një i tillë njeri zgjidh disa problema, që paraqesin pakë a shumë një farë vështirësie dhe që të tjerët s' mund t' i zgjidhin kollaj.

Studimi i ynë do të zgjatet për sa i përket kuptimit të dytë të mendërisë.

**Funksioni e domëthënëja e mendërisë.** — Së pari duhet të pyesim se cili është roli ose funksioni i mendërisë në jetën e individit; me fjalë të tjera ç'detyrë plotëson mendërija në jetën t'onë. Kësaj pyetje mund t' i përgjigjemi fare mirë: mendërija është një mjet përshtatjeje që hyn në punë, kurse mungojnë mjetet e tjera të përshtatjes, që janë instikti e shprehija; mendërija pra ndërhyt në atë çast kurse njeriu gjendet ballë një rrethane, një rast të re a një problem, ku nuk mbaron punë as instikti as automatizma e fituarë, këta dy të fundit kryejnë disa veprime që janë përsëritur kaqë herë, kurse mendërija është një mjet (d. m. th. se ne e përdorim si një farë mjeti) për të zgjidhur disa problema të reja. Për të mbyllur sytë para një drite të fortë, ose për t' u kthyerë në shtëpi, nuk është nevoja për një mendëri, por për të sgidhur një theoremë gjeometrije, a për t' i bërë ballë një rreziku të pa pritur, kemi nevojë për mendëri.

Si shohim pra mendërija i përgjigjet një farë nevojë; ajo është e nxitur, si çdo aktivitet tjetër prej një nevojë. Nevoja e veçantë që shtyn mendërinë për të vepruarë, është nevoja e të përshtaturit, e, kjo nevojë vjen kurse individi a njeriu gjendet

i pa përshtatur në rrethanat e tija, d. m. th. para një probleme të re.

Tani të shohim pakë se si qëndron puna e nevojave në jetën e njeriut; në çdo çast njeriu shtyhet që të ndjekë vijën e interesit më të math (ligja e interesit të çastit) d. m. th. do të plotësojë atë interes, atë nevojë që i paraqitet aty për aty, mbassi pa plotësimin e kësaj nevojë nuk mund të shkojë përpara; në qoftë se për mbi këtë vijë (mund t' i parafytyrojmë në nevojat që kemi për të plotësuarë si të vëna në një vijë) na paraqitet një pengesë e papritur, atëherë doemos ka një ndalesë (heurt; choc): nevoja e parë që e shtyantë njerinë të veprojë nuk mund të kënaqet (mbassi doli pengesa) dhe kështu vjen më një herë një tjetër nevojë që e vë në punë mendërinë. Të marrim një shembëll: një fëmijë që ka uri do bukë (kjo është nevoja kryesore e tij), por nuk ka para që të blerë (kjo është ndalesa që nuk mund të kënaqet nevoja kryesore, d. m. th. interesi i çastit, të gjeturit e bukës). Kështu pra vjen kjo nevojë e re (nevoja e të zgjidhurit të problemit për para) që do të shtyjë mendërinë për plotësimin e saj: këtu duhet të shikojmë mirë, se si nevojë çasti kemi problemin e parasë; kjo është më afër nesh.

Me një fjalë pra mendërija varet prej nevojave që i zenë vendin njëra jatrës, dhe që, ajo, përpiket gjithëmonë të realizojë plotësimin e nevojës më të re. Me kaqë besoj se është mjaft për të kuptuarë rolin që los mendërija në jetën t'onë.

**Lindja e mendërisë.** — Për të kuptuarë më mirë funksionin edhe do më thënënenjen e thellë që ka mendërija, duhet të bëjmë një kërkesë mbi originën e saj: Aty më lart thamë se mendërija ndërhynte kurse as instikti, as experienca e fituarë, nuk mjaftonin t' i jepnin njeriut përshtatjen e duhur në rrethanat e reja.

Të marrim një pyetje tjetër: Ç' do të ngjante vallë sikur të vinim një kafshë, ballë një situacion të ri, drejt të cilit, ajo të mos këtë asnjë automatizëm trashigonjëse ose të fituarë? Nga pa zotësia e saj a do

të rrinjë ajo si e ngurosur? N' asnjë mënyrë jo; e venë para rrethanash a problemash që kërkojnë një mëndëri të cilën ajo nuk e ka, kafsha, kërkon që të dalë prej kësaj probleme: ajo kërkon, provon, kërkon me tamin (tâtonne), do të gjejë çdo mënyrë për të dalë nga problema. Kjo kërkesë e errët (tâtonnement) (nuk munda të gjej një fjalë shqip në këtë kuptim.) lejon shpesh herë kafshën që të dalë nga problema. Me këtë rasë shohim se krahas me instiktin e automatizmin kemi një tip të tretë të të sjelluri, d. m. th. për t' u përshtatur rrethanave; këtë tip ne mund ta shikojmë si farën a lindjen më të parë të mëndërisë, mbassi ky tip ka në vet-vehte kërkesën, dhe se vetëm veprimi a përshtesa e të kërkuarit është karakteri i vërtetë i mëndërisë, pa kërkesë nuk mund të ketë mëndëri; mënyrën e veprimit të kërkesës s' errët e gjejmë gjithashtu dhe në shkallat më të ulta të kafshëve.

Ne nuk jemi të një mendimi me ata që thonë se mëndërija është një fenomen i dukur në një kohë, kur se të qenmet kishin një farë zhvillimi dhe pa lidhje me të shkuarën a me mënyrat e veprimit të më parshëm; s' mund të themi pra se mëndërija erdhi përnjëherë, kurse njeriu pat mbërritur një farë zhvillimi. Nga ana tjetër nuk mund ta nxjerrim mëndërinë as parashku-

esin e saj, kërkesën e errët ase të kërkuarit me tamin, prej instiktit ose shprehisë; këto tri mënyra veprimi (instikt, shprehja e experiencë e fituarë, kërkesë e errët) janë të zhvilluara paralelisht dhe nuk dalin njëra nga jatra.

Thamë se kërkesa e errët a me tamin është si fara e parë e mëndërisë, por nuk duhet ta konsiderojmë si një mëndëri të vërtetë, ajo është ekivaleni funksional i mëndërisë; në qoftë se mund të themi se nuk ka veprim mendor pa mos pasun kërkesë, përkundra çdo kërkesë nuk mund të themi se është mendore (që ka mëndëri). Kërkesa që bëhet me tamin është krejtësisht në dorë të fatit, të rasës, kurse një kërkesë mendore e vërtetë është e udhëhequr ose e kontrolluarë prej mëndërisë, d. m. th. kjo kërkesë është sistematike. Në kërkesën e errët provat që bën njeriu a kafsha për të dalë nga problema, varen krejtësisht prej rrethanave të përshtatshme të problemit; subjekti përpiket t' a zgjidhë problemin në atë sa e sheh së jashtëmi, pa u-thelluar në strukturën e vërtetë të problemit; në kërkesën mendore, përkundra, çdo provë a kërkesë është e sistematizuarë. Ky është pra ndryshimi i këtyre dy llojë kërkesave.

( vijon )

Kahreman Ylli '35

#### E. Abel. ( Education )

## Ç' është Edukata e Re?

Kësaj pyetjeje flamurtarët e edukatës së re i përgjigjen po thua kështu: "Sistem pedagogjik që bazohet në parimin se fëmija nuk është bërë për shkollën, po shkolla është bërë për fëmijën ..

Me të vërtetë kjo formulë përmbledh në Francë dhe gjetkë emrat më të mëdhenj të lëvizjes pedagogjike të kohës sotme: Piaget (në Svicër) Dr. Decroly në Belgjikë, Henri Wallon në Francë e J. Dewey në Shtetet e Bashkuara.

Gjer sot kishte fituar dhe ish në fuqi teza e kundërt dhe sociologë të

shquarë, si Durkheim, vënë si qëllim t'edukatës "të sigurojë të përshtaturit e fëmijës në një farë forme shoqërore.. Mirë po të përshtaturit nuk pajtohet me aspiratat natyrale dhe imponon shumë herë shtërngesa, refuzime, ligjë e rregulla. Dukesh e llogjikëshme pra që shkolla—për të mos i munguar detyrës së saj shoqërore e të bëjë gati brezat e rij për një mënyrë rrojtjeje të pastajme—u mundua që të formojë adultët, ku fëmija shpikësh jo me dëshirën e natyrës së tij por me forcën e gjërave shoqërore.

Përfundimet : Fëmija i dorëzohet shkollës së detyrshme, jo për t'u shvilluar si pas prirjeve të natyrës së tij të veçantë, por për t'u mbushur me njohni të çdo fare, pa të cilat lidhja intelektuale me të ngjajshmit e tij nuk munt të kryehësh.

Në këtë shkollë që është ende më shumë e përhapur, programet nuk janë berë për fëmijët; ato paraqesin sasin e shumë njohnieve që një fëmijë çfarëdo, në një moshë të caktuar, duhet të dijë për t' u futur në jetën shoqërore.

Metodat nuk u përgjigjen aq aftësive të fëmijës. Ato mundohen të lejojnë për shoqërinë një maksimum ekonomije kohe e të hollash.

Provimet dhe konkurset nuk shikojnë vullnetin e mirë të fëmijës, nisiativat e tij a pelqimet personale. Ato gjykojnë thjeshtësisht rezultatet e mbritura si mbas kuptimit që formon shoqëria mbi vlerën e rëndësinë e tyre relative.

— Në të gjitha kohët edukata e ka paraqitur këtë karakter shtërngimi kundër natyrës, por shpeshë gjatë kohës janë ngritur mendje për ta kundërshtuar këtë abuzim: në të XVI shekull Rabelais, Erasme-i, Montaigne; në të XVII. Bacon, Descartes, Fénelon e më në fund në të XVIII shekull J. J. Rousseau që qe flamurtari i vërtetë dhe drejt për së drejti i Edukatës së re. Idetë e tij themelore — pafajsi (innocence) e parë e fëmijës, nociviteti, prishja e instituteve shoqërore, nevoja e të ndjekurit të natyrës për ta berë fëmijën njeri me kuptimin e plotë e të përsosur të fjalës — patën mjaft sukses dhe sidomos pranë Pestalozz-it e Fröbel-it.

Por problema e shtruar prej novatorëve me Rousseau-n në krye, nuk është vetëm një problemë pedagogjike e morale ajo është dhe një problemë politike e shoqërore e dorës së parë, mbassi ajo pyet ne se duhet ta formojmë njerin për një farë tipi të jetës shoqërore ose (përkundrazi) për vehten e tij ose, me tej, për një njerëzim të lartë të pavarur nga hapësira e koha.

Në të vërtetë, në se këto doktrina janë zhvilluar. Sikurse ka ngjarë kto vjetët e fundit janë zhvilluar nga që janë ndihmuar prej disa rrethanave dhe disa konsideratave të veçanta. —

— Gjatë këtyre 50 vjeteve të fundit njohja e mëndëris foshnjore (q' përmbledh ajo, mënyrat e veçanta të funksionimit dhe të etapavetë zhvillimit të saj.) ka bërë përparime të mëdha. Për hir të punimeve të Piaget-it në Svicër, të Baldwin, të Preyer, të Foerster etj. pedagogjija e re ka një themel shkencor me të vërtetë të fortë e mbi të cilën munt të mbështetemi kështu e tutje.

Nga ana tjetër kataklismat e mëdha të kohrave të fundit: luftë, konkurrencë ekonomike, papunësi e përgjithshme, revolucione politike, i kanë shpënë mëndjet të mendojnë mos të gjitha këto të këqija vinë nga një drejtim i keq që i është dhënë pedagogjis së shkollës.

Kështu që problema e edukatës mbështetet më tepër në një plan politik e shoqëror se sa në një të tillë psikologjik e pedagogjik.

Kuptohet pra që një lëvizje e tillë, procedon përpara çdo gjëje nga një kritikë e sistemit të vjetër.

Flamurtarët e Edukatës së re duan që kje e fundit, duke formuar njerinë të synojë:

1 Që të formojë qytetarë të përshtatur një sistemë t' institutave të lira, ku individvetë gjykon ç'kërkon e mira e përgjithshme.

2 T'i japë njeriut modern shpirt pozitiv, ta mësojë të gjykojë objektivisht e pa anësisht për çdo gjë, ta bëjë t' aftë që të çmojë rolin që lozin në botë kërkimet me të reja shkencore; më në fund ta formojë posaçërisht duke marrë parasysh mjeshtërinë e veçantë që do t' ushtrojë.

Pra programët e sotme, cilatdo që të jenë, s' u përgjigjen o e u përgjigjen keq këtyre nevojave: ngarkim i tepërt, formalizmë i vjetër, provimet që të shpënë më shumë në njohjen e njohnieve të fituara se sa në zhvillimin e aftësive intelektuale, karakter shumë intelektualist për dëm t' edukatës burnore (formim i karakterit e i vullnetit.)

Sa për metodat pedagogjike, sa të jenë në veprim programët, ato mbesin autoritare, didaktike, ku shtërngohet mësuesi të bëjë mësimet të shpejta, të vërë në punë me shumë kujtesën, të rrethohet me instrumenta pune që ia lehtësojnë barrën e tij, libra, revista, mësimet të zhvilluara, të gjitha këto në kurrir të kërkimit të lirë, të metodave të vërteta dhe të mendimit shkëncor.

— Me të drejtë kanë thënë që përparimi i mendjes shkencore (esprit scientifique) që qëndron në një vrejje dhe gjykim të lirë, pengohesh aq më shumë sa më e madhe ishte shuma e njohive për të thithur.

Nga kjo pedagogji rrjedhin pastaj metoda disiplinore të njohura mirë: autoritarismë, e ngushtë dhe e ashpër, me vargun e dënimeve e të shpërblimeve: Mësuesi urdhron, ndeshkon, nuk munt të jetë këshilltar, udhëheqës, mik i mirë i nxënësit.

Për flamurtarët e Edukatës së re, përkundrazi, fëmija, duke u mbajtur në një qark lirie të përshtatur, shpiket që ta ndjejë ai vetë nevojën e disa rregullave. Kështu që shoqëria e vogël shkollore, e formuar lirisht nga ligjet e saj të gjykuarë të nevojshmë, do të jetë pararendësja e një republike të madhe e të lumtur qytetarësh.

Si duket Edukata e re karakterizohet pra nga disa parime të mëdha:

1. Vullnet për të rregulluar edukatën pas natyrës të fëmijës vetë (gjë që kërkon një dije të thellë të kësaj natyre.)

2. Besim në mirësin e vetvetishme të fëmijës; vullnet për të siguruar me anën e Edukatës të çelurit e natyrës foshnjore.

3. Bindje që fëmija nuk munt të trajtohet si një i math.

4. Vullnet për t'i dhënë si qëllim të parë kulturës intelektuale formimin e "shpirtit kritik": dëshirë për vrejje direkte, për kërkime personale, përdorim më i tepërt

i metodave intuitive e aktive.

5. Vullnet që edukata të sundojë mbi arësimin (intsruksion) pse është puna që përpara çdo gjëje, të formojmë njerës me karakter, të bërë gati për nevojat e jetës dhe jo të formojmë rafte ndodhirash, fjalësh e formulash.

6. Dëshirë për të rregulluar një edukatë që sjell gëzim, duke e rrethuar fëmijën me një atmosferë gëzimi të kurdoherëshëm.<sup>1)</sup>

Ky është përgjithsisht programi ideal i edukatës së re. Realizimi i saj integral do t' ishte me të vërtetë një ndryshim i math pedagogjik, por ky qëllim në konditat e sotme nuk munt t' arrihet veç se pjesërisht. Do të duhej të rindertohejshin një numur i math shkollash, shtesë e madhe e shpenzimeve, rekrutimi i një personeli të shuntë dhe me të mirë.

Po shkollat e reja sot munt të shikohen vetëm si laboratorë prove pedagogjike, ku ndiqen kërkime, ku shtrihen nisiativa qi duhet të provohen përpara se të futen në një plan riorganizimi të përgjithshëm.

Po me gjithë këto duhet thënë se përfundimet e mira që ka dhënë deri sot edukata e re, i detyrohen cilësive të jashtëzakonshme të një personeli të zgjedhur, të bindur në fisnikërin e detyrës e ti zjarrtë për t'i dalë mb'anë. Po një personel shumë i math (d. m. th. për të gjitha shkollat) nuk munt të formohet kryekëputë prej edukatorëve të zgjedhur. Nga ana tjetër përvoja e shkollave të reja ka kallxuar se shpresat të një mirësi natyrale e fëmijës kanë qënë të gabuara.

Po këto pakë rezerva nuk e prishin aspak bukurin, fisnikërin e përpjekjes të bërë në lëmë t' edukatës së re.

Shpirti që frymëzon flamurtarët, shpirt lirie krijonjëse, dashuri për fëmijën, fli për miturinë duhet të frymëzojnë gjithë edukatorët të çdo shkalle qi të jenë.

T. Reovica.

<sup>1)</sup> Edukata e Re e ka si qëllim gëzimin (red.)

# Përkëthimet Pedagogjike.

Sot për sot këtu ndër ne, ku mungon, po thuajse, edhe lëvizja mendore arsimore më e shurdhër, përkthimet pedagogjike janë shumë të nevojshme. E theksojmë me bindje këtë gjë, por-po, kemi një por-në ç' mënyrë na janë të nevojshme këto përkthime, a në ç' mënyrë duhet t' i bëjmë pronë t' onë mendimet pedagogjike më të vlerëshme të pedagogëve më zulumë mëdhenj të botës? E... mandej në ç' mënyrë duhet të përfitojmë nga përvojat shumëvjetëshe të të huajve? Edhe përvojat duhen përkëthyer? ! Po, edhe përvojat, medje ato janë më të vështira për t' u-përkëthyer se sa mendimet vetë.

Nuk na bën zemra aspak që të mo-  
hojmë një të vërtetë të hidhur: Të gjitha përkëthimet e gjertanishme-duke përmbledhur artikujt e ato disa veprëza që nga krijimi i jetës s' onë arsimore-janë vetëm përkëthime fjalësh, medje shumica edhe pa as një shije letrare e që nuk përmbajnë as gjë nga ato që i duhet mësonjësit shqiptar për jetën praktike. Për vërtetim e për çudi ç' fletësoni të gjitha serit e ish të përkohëshmeve t' ona pedagogjike e me habi do të shikoni se çdo artikull flet në mënyrë, t' idealizuar se si mund të shkeli krenarisht mësonjësi mbi qilime të shtruara, pa e mësuar më parë se si duhet qeruar gjëmbat një herë mirë e mirë, pa... pastaj për të shtruar qilimat e... shumë më pastaj për të... shkelur krenarisht mbi to! Çdo përkëthim duket pra sikur është shkruar dëllëngthi për të lëvruar edhe më arsimin e huajit! Me këtë harrojmë vëhten t' onë, harrojmë nevojat t' ona, harrojmë realitetin e jetës s' onë

Kur duam të përkëthimë një pjesë a një vepër pedagogjike, së pari duhet të marrim përpara sysh se për ç' vënd shkruan autori edhe për ç' vënd do ta përkëthejmë ne: duhet ditur mirë se për cilët nxënës flitet aty edhe për cilët nxënës kemi ndërmend të flasim ne; e më fort duhet të vemë

re se cilit mësonjës i drejtohet autori e cilit mësonjës do t' i drejtohem ne; d. m. th. përpara së gjithash edhe në përkëthim duhet marrë përpara sysh rrethi-jeta-gjendja shqiptare.

Ata që mirren ose që do të mirren me përkëthime pedagogjike, duhet të përkëthejnë një ato shkrime a vepra, që kanë më fort lidhje me gjendjen t' onë e që janë shumë të ngutëshme për nevojat t' ona. Por përgjithërisht shkrimet pedagogjike të të huajve më të shumtën e herës nuk i përshtaten nevojës s' onë, e këtu duhet të hyjë në punë zotësia e përkëthenjësit, i cili ose ta përshtati shkrimin simbas nevojave t' ona duke shkruar më fort si në mendim origjinal, ose ta përkëthejë shkrimin të tërë duke e përcjellur me shënime e tij kritike në lidhje me gjendjen t' onë arsimore. Po, edhe me shënime kritike, qofshin ato edhe pa ndonjë rëndësi të madhe, mjafton vetëm me shërbimin që do të sjellin dyke e shtëinë edhe tjetrin për të menduar. Pra puna s' na pret që të përkëthejmë gjithë farë shkrimesh pedagogjike; p. sh. hë për hë është një humbje kohe të mirremi me përkëthimin e Emilit të Rousseau-it, kurse ne na presin për të kryer kaqë e kaqë punëra të nevojshme për gjendjen e tanishme arsimore. Edhe përvojat e të huajve duhen futur në përdorim me një të përshtatur, përndryshe nëpër duar mbajmë flluska sapuni. Kështu pra çdo methodë e përkëthyer pa as një bazë studimi mbi arsimin t' onë mua më duket se nuk kryen ndonjë punë të madhe. Si shembëll përpara meje kam një librëzë prej disa faqeve, ku përmbledhen shkurt shumë methoda të ndryshme si kuptimi i Snkollës aktive, methoda e Decrolyt, ajo e Montessorit, meth. fonomimike atë; mirpo dyke i lëçitur gjithë ato methoda të shkruara aqë thatë e pa as një shënim kritik për brinj, më duket sikur po më rrëmben një shterpësi e tmerrëshme mendore. E pastaj mendoj se në ç' punë do t' i

hyjë mësonjësit shqiptar ky libërth aqë përmban vetëm emra methodhash pa as një provë, pa as një studim më të gjërë e pa as një të përshtatur gjëndjes s' onë arsimore? Për as gjë: për atë do të mbetet po ashtu sikur edhe të mos ishte botuar.

Nga këto kuptohet se përkëthenjësi pedagogjik nuk duhet të jetë njeri si do kudo; ai, veç kulturës së përgjithëshme pedagogjike, duhet të ketë edhe një dijeni të plotë për gjëndjen t' onë arsimore.

St. Spasse.

## Larg rregullave formale me natyrë ushtarake.

Dalë para kolegëve të mij, arsimtarë, me përmendë disa vërejtje, që më duken t' arsyeshme, rreth disa rregullave formale, që shumë ndër ne i përdorim shpesh në klasë e jashta 'sajë.

Dihet se puna që nxënësit e sotshëm janë pak më t' aftë e më të gjallë se të djeçmit, i detyrohet reformave të reja pedagogjike, një ndër të cilat dhe më me rëndësi është edhe lirija e vetveprimit. Shembulla, ku duket sheshazi frukti i mirë i liris së vetveprimit—natyrisht ndën mbikqyrjen e kujdesin e njëj edukatorit plot anloritet e dashuni — janë shkollat moderne të të gjithë botës së qytetnueme.

Na tue mos dashtë me qenë shumë mbrapa të tjerve në çashtje arsimore, gjë q' është ushqimi i shpirtit të njëj populli, duhet dita — ditës me me mendue mirë për çdo veprim pedagogjik që përdorim: a) tue marrë të mirat e tue ja përshtatë konditavet të vendit, po ta lypni nevoja: b) tue nxjerrë të kqijat jashtë përdorimit me mashë.

Shum ndër veprime pedagogjike, që na ende i përdorim sot e që na duken të reja e të mira, ndër vënde të qytetnueme, ku arsimit ecën me hapa vigane, janë vjetruet e kanë zënë myk.

Asht turp pra për ne me ndejtë me duer lidhë e me e lanë gjëndjen arsimore ashtu si e gjetëm. Kemi shumë gjëna, që duhet të lehen jashtë përdorimit, një ndër të cilat, që due me zënë sot në gojë, është dhe komandimi ursharak në klasë e jashta

klase. Shum ndër ne, kur duem që nxënësit të nxjerrin prej bankës: libër, radhuer, pllakë ose me i ngritë në kambë, përdorim komandime të preme me anë numrash:

pllakat jashtë. — — — 1 — 2 — 3.

librat „ — — — 1 — 2 — 3.

radhojt „ — — — 1 — 2 — 3.

gadi me u ngritë — — — 1 — 2 — 3.

Të tilla komandime, që përdoren shpesh nga mësuesi, që e ka bërë modë, detyrojnë fëmijet e njomë e me frymë të lirë me ndejt gadi për me zbatue orë e çast urdhënat ushtarake të mësuesit. Mos me pasë dorën me libër naltë, kur mësuesi numëron... 3 është frikë e madhe për nxënësin...!

Kto urdhna aspak të lira, që për degen t' onë s' janë tjetër veçse rregulla formale, nuk shifin tjetër—kund, veçse në kazermë. Nxënësit të vogël, të cilit kurrë s' i ka qëllue ndonjherë me u gjindë para një sëri të tillë komandimesh as në jetën t' onë familjare. i vjen çudi. friket, mërztitet, mënin shkollë e mësues e pret si e si të mbarojë ora e të dali jashtë në jetën e lirë, ku është i sigurtë se s' e ndjek më mësuesi i 'tij.

Nuk them se kjo shembull që kallzova unë është një e metë e madhe, por është një nga të metat e vogla. që sëbashku me të tjerat formon plagë në shkollën t' onë e shkakton që nxënësi t' a quej shkollën burg a kazermë.

Ndoshta shumë-kush kishte me m' u përgjegjë se me anë t' atyne komandimeve

e të tjera si kto, fitojmë pak kohë e i detyrojmë nxënësit të kenë rregull në punë.

Jo s'është ashtu. Mësuesi i mirë gjenë tjetër rast kur e fiton kohën e jo me komandime të mërzhitshëme. Le që është gjá qesharake me caktue ktu se sa kohë mund të fitontel Mandej dhe rregulli në punë nuk i rranjoset me imponim, por me dashuni, shembulla e vet veprim. Përgjithsisht kto rregulla abstrakte nuk gjejnë vënd më në shkollën e sotshëme.

Për të forcue mendimin, se kto janë më tepër të dëmshme se sa të dobishme, shkëpusim e botojmë këtu disa pyetje e përgjigje nga libri " **Theori e praktikë e mësuesis,** :

1) A është e këshillueshme me përdorë shum apo pak rregulla në klasë?

Rregullat e shumta ngatarrojnë e rëndojnë nxënësit e shumojnë faqet e 'tyne. Rregullat në klasë duhet t' jenë sa më të pakta që t' jetë e mundun — dhe ato — jo abstrakte.

2) A është e mundun të bëhet punë në shkollë pa qenë nevoja me përdorë rregulla formale?

Po, disa mësues të mirë bajnë edhe pa 'to fare.

3) Cilat janë disa mjete, që përdoren për me mbajtë qetsi e rregull në klasë pa shtrëngime?

Tue mbajtë nxënësit në punë tue zgjue interes e tue ndryshue detyrët në mënyrë që të thyhet monotorija.

Rregullat formale—teper të mërzhitshëme për fëmijet — kanë fuqi të transformojnë një klasë të gjallë e krejt jetë, në një heshtje vorri, thotë një pedagog i ndëgjuem.

Nji tjetër gjá, që s' duhet lënë pa u përmendë, është edhe të dalunit e të hymit të nxënësve përherë në rresht e shka është edhe më keq, kur marshojnë me numërin nëpër koridore, dhoma e jashtë ndën urdhën të mësuesit. S' mjaftojnë pra komandimet në klasë, por edhe jashtë . . . ! Teprica ! me të vërtetë teprica ! Nxënsi në shkollë bëhet orë e çast rob i urdhnave ushtarake të mësuesit: 1 — 2 — 1 — 2 dhe 1 — 2 — 3 etj.

Nuk duhet të mendojmë aspak se, vetëm në rresht e tue marshue, mund të hyejnë e të dalin nxënësit në rregull e pa báz zhurmë.

Nji këshillë atnore e nji mbikqyrje e qetë e plot dashuni, mjaftojnë të mbajnë një farë qetsije, se edhe fare të qetë s' i duem nxënësit t' onë.

Shkolla është sot strehë gjallnimit-strehë jete e jo kurrë strehë vdekjeje, ku mbretëron qetsija më e madhe.

Tue përfundue, përmbledh pra verejtjet e mija në dy pika kryesore:

1) Që rregullat formale — e më tepër nga ato me natyrë ushtarake që përmenda — të cilat vihen në sbatim prej disa të paktëve mësues të filllorevet t' ona të zhduken ose të paktën, për të thye monotonin, të zavëndsohen me urdhëna atnore, që zbatohen jo nga frika, por nga dashunija e respekti që kanë nxënësit për mësuesin e 'tyne.

2) Që nxënësve t' u epet liri e plotë vetveprimi në çdo punë, natyrisht ndën mbikqyrjen e kujdesin e nji mësuesi fytyrë-çelë e plot autoritet.

. . . . . Nji mësues.

## Randësija e lojës n'edukatën fizike të fëmivët.

### II.

Loja gjimnastikore është ajo qi, tue pasë të gjitha karakteristikat e lojës përgjithësisht, ka si element të domosdoshëm e të randësishëm lëvizjen.

Ajo qi pat randësi të madhe pranë

popujve të vjetër, mbas nji periudhe të gjatë harrrese, ktheu nderimisht më rilindjen dhe interesojti studjozë të shkëlqyeshëm të problemavet edukuese.

Qysh në fillim të '400, Vittorino da

Feltre e ngriti nalt "sikurse ate qi i jep shëndet trupit, ndalon kputjen e pasionavet të shtymë prej përtesës e prej dobsis, dhe e bân shpirtin mâ të gatishëm në të menduem..".

Nji element kryesuer i lojës është gëzimi, i cili, në qoftë se ka shumë randësi në pikpamjen morale, nuk ka mâ pak n'ate fiziologjike. Lagrange-i, fiziologu i math qi ka studjuem aqë thellësisht edukatën fizike; në librin e tij t' interesanshëm "Hygjiena e ushtrimit," thotë se fëmit kanë nevojë për gëzim sikurse bimët për dritë. "Drita nuk është nji ushqim për bimën, por nji nxitës i nevojshëm për disa fenomene qimike të tretjes; gëzimi është nji nxitës i trupit, qi ka parapâ natyra e pa të cilin ekuilibri i jetës nuk mund të jetë i përsosun..".

Mbasi lëvizja është nji faktor tjetër kryesuer, rrjeth se gjithë organet e sajë qi veprojnë a drejtojnë lëvizjen, tue u-stërvitun, zhvillohen e perfeksionohen numri i math i lojnavet e ndryshimi i tyne japin mënyrën se si me zhvillue e forcue armonisht trupin, me shtuem fuqin' me i bâmë të shkathta e të përkulshme gjëmtyrët, me perfeksionuem ndiesin muskëlore, me i dhanë subjektit sundimim e lëvizjeve të ndryshme, të cilat, tue u-plotsuem gjithnji e mâ tepër vehtësisht e natyrish, premtojnë qi të bëjnë nji punë mâ te madhe me nji shpenzim mâ të vogël energjish.

Organet e ndiesis e në mënyrë të veçantë ata të të ndigjuemit e të të pamunit, hyjnë në veprim gadi në të gjitha lojnat, por mbi të gjitha në disa qi, të krijueme posaçërisht, shërbejnë për me i edukuem e perfeksionuem.

Kështu organet e të të marrunit frymë e të qerthëllimit të shtymë prej aktivitetit mâ të math muskëlor. shpejtojnë veprimin e tyne, forcohen e, tue i cuem nji ushqim mâ të shumtë e mâ të mirë gjithë organizmit, bashkëveprojnë për zhvillimin e tij.

Të mirat intelektuale në lojë janë sigurisht mâ superiore se ata qi fitohen

në forma të tjera t' edukatës fizike, qi futet e komandohet gjithmonë.

Djali i lirë në të menduem e në të vepruem mbrenda nji sheshi mjaft të gjënë, për përfundimin e mirë të punës e të lojës, është i detyruem gjithmonë me vumë verejten e vet pa dâ gadi në shumë gjëna, me krijuem planin e veprimit të vet e me e zhvillue me gatishmi e shkathtësi, nga ndonji herë me e ndërrue shpejt e shpejt, simbas nevoj-vet, kështu qi gjithë veprimet intelektuale, tue u-stërvitun vijimisht e në të gjitha drejtimet, xjerrin dobit qi rrjedhin prej ushtrimit e këta të mira janë edhe mâ të mbëdhâ, sepse ushtrimi nuk imponohet.

Të mirat në radhën morale, qi mund të dalin prej lojës. janë me randësi aqë të madhe sa kalojnë së tepërmi, si mbas mendimit t' im, ata fizikët e intelektualët të vumë bashkarisht.

Asnji mjet nuk mund të krahasohet me lojën në zotësin edukuese për rinin. E kjo ka qenë ndigjuem në mënyrë të tillë, sa gjithë edukatorët kanë shkru faqe të çuditëshme për ate pikpamje' shumë nga të cilat kanë ngelë si rregulla mâ të mira.

Edhe sot shpesh-herë loja praktikohet si kaluese kohë e thjeshtë e nuk janë pak ata qi e kufizojnë detyrën e tyne në të mësuem të rregullavet e kujtojnë se ndodhja e tyne, kur është efektive, është e nevojshme vetëm qi të mos ngajë ndonji shregullim a fatkeqësi.

Veç kësajë asnji fushë tjetër nuk i jep mjetet mâ të mira për me studjuem, korregjuem e drejtuem rinin kundrejt të mirës, shpirtmirësis, të drejtës e të bukrit.

Fëmija rroket prej entuziazmit të lojës e të liris së veprimit për me treguem gjithë shpirtin e vet.

Frikacaku rri m' n' anuem e është gjithmonë mâ i fundit në veprime qi kërkojnë zemër, egoisti e do për vehte vendin e pjesën mâ të mirë, guximtar i asht gjithmonë i pari në të përballuem të pengesave e vështirsinave, shpirtmiri përpiqet pa pushim jo vetëm për interesin e

vet por të gjithë skuadrës qi ban pjesë, i urti gadi gjithmonë i qetë e i disiplinuem bân qi të ndihet pak me qenëjen e vet, inteligjenti përmend dhe përdor gjithë mprojjtjet vetëm qi të fitojnë, e të gjithë në një kohë të dhânume, në një rast të dhânun, tregojnë cilësit e mira të tyne, zbulojnë të metat e tyne, tue i dhanë mësuësit mënyrën se si me ushtrve tansisht veprimin e tij edukues të naltë e bâmirës.

Nuk është i rrallë rasti në të cilin një lavdim i dhanë me kohë një thirrje, një qortim ose dënim i dhanun me vend, mund të kenë përfundime të caktueme mbi formimin e karakterit të të rivet e as në ndonjë fushë tjetër edukatori nuk është në gjendje qi të gjuet një shëj e me kohë.

Lojat, e bazueme më tepër n' emulacionin, nxisin dashunin e vetvehtes na bëjnë zakon me luftue sot për një fitim të thjeshtë në shkathësi a zotësi, nësër për qëllime më të randësishme e më të nalta.

Lojat me skuadra na mësojnë më jetuem në shoqni, me vuetë e me ndihmue njëni tjetrin e, të lánun në shoqni me shokët e tyne, fëmijit mësohen për jetën.

Lojat e ndeshjet me skuadra bëjnë zakon punën e rregullushme për interes të përbashkët, shuejnë ndiesit egoistike e me superioritet individual, tue ndërhy me shumicë me formue e me forcue ndiesit e kolektivitetit e të bashkveprimit, qi janë bazat e jetës së kombit.

Djali qi, mbas një pune të gjatë e me mundime me qëllim qi të përfundojë një veprim, në kohën e mbledhjes së frytit të punës së vet, ia lëshon vendin shokut, pse është më i mirë ose në kondita më të mira për me pasë fitimin, plotson veprim të tillë altruizmi e solidariteti, përme dhanë besim të sigurtë mbi punën e vet t' arthme, si njeri e si qytetar.

Për mue vlefata më e madhe e lojës gjiniko-sportive, veçanërisht, qëndron në këto cilësi qi mund të japin në mënyrë të veçantë e nuk harroj me çfaqë se loja sportive, qi nuk gjuen në këte qëllim të naltë, ka shumë pak të drejtë qi të jetojë.

Loja me entuziazmin qi nxjerr, tue e tërhjekë të riun në punë të lodhëshme e jo gjithmonë të lehtë as pa rreziqe. mëson me duruem lodhjen, ushtron vullnetin e ndërhy me përgatitë qytetarin e ardhshëm puntor e të qindrueshëm.

Gëzimi mbasandaj qi duhet të jetë shoqi i pandaslëm i lojës, ka vlefte të madhe morale.

Fëmij me zakone të liga përgjithësisht janë ata qi nuk kanë mënyrë me përmbushë nevojën mjaft të madhe të gëzimit. Ata dallohen lehtë, përveç nga pikpamja fizike, por edhe karakterit të tyne të heshtshëm e prej zembrimit dhe jetojnë me dashjen e tyne të ndamë nga shokët.

Kafet e vendet e qejfit janë të mbushuna veçanërisht prej djemvet qi nuk gjejnë mënyrë qi të shpenzojnë, në formë të pëlqyeshme e në gëzim energjit e tyne të tepërta.

Djali ka nevojë për gëzime, po të mos i jepet në një formë të shëndetëshme, do t'a kërkojë në formë të dobët.

Loja, e konsiderueme në këte pikpamje, mund të krahasohet me profilasin e me terapin në fushë mjeksore; ajo ndihmon dhe shëron formën e dobët të zakonit të lig qi i jep aqë dame rinis e kombit.



E kemi thanë pa gabim randësin e lojës në fushën edukative; por duhet mos me harrue se ajo mund t'i japi të gjitha dobit qi numruem, vetëm po t' aplikohet me zgjuetësi dhe të drejtohet me shpirt edukatori të vërtetë. Mund të jetë me pak randësi dhe e damshme, kur, ai qi është i propozuem në këte mision, nuk është në naltësin e detyrës së vet.

Asht e arsyeshme qi një lojë e papërshtatëshme moshës e konstruktimit të djemvet, e zbatueme n' orë e në stina të papërshtatëshme, të pashpërdamun si nevojitet, mund të sjelli dame të mbëdhna n' organizim ose nuk bije asnjë të mirë.

Përmend këtu se ndoshta loja është, ndër të gjitha ushtrimet fizike ajo qi shpër-

dorohet më tepër, sepse fëmijt, tërhequn prej emulacionit e prej entuziazmit, prihen me kryem një punë qi kalon fuqin e tyne. Nuk janë të pakta mandej incidentet e fatkeqësit qi mund të ngjajnë gjatë lojës.

Porse duhet mos me harrue se pjesa ma e madhe e ktyne pësimevet i janë të pa falshme mësuesit qi, ose nuk i ka pasë aqë kujdes nxanësve, veçanërisht ata më t'apasionuemt a më të shkalltit, ose nuk ka dijte me mbajtë disiplinën, ose nuk ka parapamë qi të zhduki pengesat qi kanë shkaktuem incidentin, ose ka lejuem përdorimin e veglavet a të veshjevet të papërshtatshme, ose ka zgjedhë një lojë të papëshatun për skuadrën; ose e ka bënë të zhvillohet në lokale, në tokë e shtresë të papërshtatun.

Damet qi mund të bëri loja në fushën morale janë edhe më të randa kur nuk është përmbytë ngushtësisht në rregulla të disiplinës, kur nuk ndiqet për një qëllim të përbashkët e kur nuk zhvillon bujarin e shpirtmirësin.

Dëshira e fitimit shpesh-herë i tërheq djemt të përdorin të gjitha mjetet, edhe ata më të palejuemet, vetëm qi t'ia mbrijnë qëllimit. Superioriteti i pambajun mirë i ndonjanit ose i skuadrës, mbas një loje të fitueme mund të shkaktojë zili e nakar jo kurrë shumë të qortueshme.

Përpjekjet personale, përplasjet nga një herë me dhimbje qi ngjajnë lehtas në vijim të lojës. kundërshtimi mbi disa rregulla të pavrejtuna mirë, shpesh-herë i lanë vend grindjevet qi shkaktojnë edhe shtytjet, të bëmuna më të ndishme prej punës e prej lodhjes, në veprime të papëlqyeshme kundrejt shokëve.

Mësuesi të parashofi me sa të mundet, por të jetë i rreptë e të mos dali jasht rregullavet për shtypjen e të tilla ngjarjevet të papëlqyeshme, si do qi të vinë.

Loja duhet të jetë mbi të gjitha shkollë e bujaris, e shpirtmirësis, e kalorsis; kërkohet pra gjithnjë qi të jetë bujar kush humb, shpirtmirë kush fiton, po të duhet qi ajo t'a vllaznojë djelmënin e jo t'a ndajë

Elbasan, Mars 1937.

Spiro Shuteriqi.

## Provë mësimi

### Dhanë në klasën e IV t' Ushtrimores Elbasanit

Landa M. Natyre.

**Tema** Zoqt këndues (bibili).

**Mjete** Nji kafas me një bilbil, karta me zoq këndues e ve laraske.

**Disp.** 1) Koha e t'ardhunit.

2) Përshkrimi i trupit të bilbilit.

3) Banimi.

4) Shtimi.

5) Ushqimi.

6) Dobija.

7) Të zanunit.

8) Jeta e bilbilit.

9) Zogjt tjerë këndues : mulleja  
qyqja etj. në krahasim me bilbilin.

### Zhvillim.

**Hyrja.** Si hyrje e paraqitje për këtë mësim munt të bahet nxjerrja e kafazit me bilbil mbrenda, por është frikë se nxanësit mos tërhiqen mjaft prej kësaj pamjeje dhe s'kanë me e pasë mendjen në mësime gjat orës, tue pasë ndërmend gjithnjë kafazin e bilbilin, qoftë edhe se në i hekim prej syvet të tyne. Prandej për me u rrejtun nga këjo mësuesi kafazin me bilbil duhet ta paraqisi në minutat e fundit t'orës, ku ka me i shërbye dhe si një pjesë e përmbledhjes. Si hyrje pra e këtij mësimi ka m' u-kërkue shkaktarët e zburimit të stinës së Prandverës për të cilët fëmijt kanë folë dhe herat tjera. Këtu kanë me dalë : lulet, bari zogjt etj. Kur vjen puna ke zoqt (bilbil) mësuesi qëndron dhe kërkon prej nxansave t' i kallzojnë diçka mbi bilbilin.

**Paraqitja.** Gjat kohës së kallzimit të pjesëshëm që kanë me bënë nxanësit mësuesit duhet të nderhyjë e me doemos në gabimet e të folunit, por këtu jo drejt për së drejt vetë, por me ndihmën e shokvet; detyra e mësuesit në këte rasë sikurse edhe në shumë rase tjera është vetëm të nxisi. Mbassi të jet mbarue kallzimi nga nxansit, mësuesi fillon të vëjë në rrjesht dhe të plotsojë mendimet e nxansavet, gjith herat në bashkëpunim me nxansit. Tani mësuesi

mundohet gjithnji të shkoi mbas pikave të dispozicionit.

**1) Koha e t'ardhunit.** Pse s'e kemi ndigjue deri tani afër këte zog? Natyrisht kanë me dalë përgjegje të ndryshme nga nxansit: kush pse iku Dimni, kush pse erdhi Prandvera kush pse çelën lulet etj. Mësuesi të gjith këto përgjegje duhet t'i presi me gëzim dhe më në funt prej këtyneve të nxjerri fjalën e plot e ta përsërisi prej dy tre nxansave, edhe mandej e shkruen në dërrasë të zezë.

**2) Përshkrimi i trupit.** Kush i ka vu mendjen mirë trupit të bilbililit? Mbassi ka asish që e kanë në shtëpijat të tyne, do të dalin shumë përgjegje: njeni flet për madhsin natyrisht tue krahasue me ndonji zog të njoftun në qoftë se nuk e krahasojnë kërkohet prej mësuesit, tjerë flasin për ngjyrën (i verdhë, i zeshkët, i larëm etj.) për squpin, për kambët etj.

Kështu merr funt përshkrimi i trupit të bilbililit dhe veprohet si në pikën e parë.

**3) Banimi.** Ku e ndëgjojmë më fort këte zog? edhe ktu kanë me dalë shumë përgjegje si nëpër pyjet, nëpër pemët nëpër ferrat etj. edhe këtu mësuesi duhet të bëjë si në fillim. Veç kësaj ai nëpër ato vende ku e këni ndigjue ose ku thoni ju se këndon ai bân edhe banimin. Këtu nx. kallzojnë si e bân banimin (çerdhen).

**4) Shtimi.** Pse e bân çerdhen? pjell ve, kallzojnë mbi ven e bilbililit tue krahasue me të laraskës që u nxiret n' ate kohë prej mësuesit, të cilat janë më të mëdhaja por nga njëjra të njëjshme. — Me disa nxitje nga mësuesi kallzohet se bilbili bân 4-5 kokrra ve të cilat dalin zogj të vegjël për 18 dit. Nx. tregojnë se si i ushqen e ama zoqt e saj

**5) Ushqimi.** Zogjt e vegjël kush i ushqen? Disa thonë zogjt i ushqen e ama, disa i ati etj. disa i ushqen me miza e insekte dhe këtu mësuesi ban si përpara. Në këtë rasë delet ke dobija e zogjvet

**6) Dobija.** Me se ushqehen zogjt? Ktu kallzojnë nxansit me insekte, me fara e me tj. Insektet qysh jan për bimët? Nx. Me të vërtet pra insektet janë të damshme për bimët pse u hanë lulet për kafshët e për njerzit pse i mërzisin.

Mbasi këto zogj ushqehen me insekte që janë të damshëm për njerzit e për bimët etj. si munt t' i quejrn? Nx. pra zogjt janë të dobishëm pse hanë insektet por edhe na kënaqin me zanin e tyne.

**7) Të zanunit.** Nx bilbili na kënaq me zanin e tij t' ambël prandej njerzit duen me ndej afër tij. Mësuesi: disa prej jush thanë në fillim se bilbilat i mbajnë në për kafazet. Ku i gjejnë këta? Disa thon se i zanë natën, disa i marrin zogjt të vegjël e disa i blejn etj. Edhe kësaj pyetje i dalin mjaft përgjegje nga të cilat mësuesi bashkë me nx do të baj mendim kryesor të cilin si ta përsërisi prej dy tre nxansave do ta shkruaj në dërrasë si tjerët.

Për ushqimin në kafaz lehen të kallzojnë nxansit. Më në funt si të jenë kallzue ushqimet e mira që u shtihen bilbilave në kafaz pyeten nxansit se a është i kënaqun bilbili prej këtyneve ushqimeve? Disa thonë se nuk kënaqet pse është ndam prej shokve, disa tjerë thon pse është i mbyllun prej katër faqeve të kafazit. Këtu e kap mësuesi edhe thekson punën e liris dhe përbuz robnin.

**8) Zogjt tjerë.** Si mbarohet puna me bilbilin kërkohen prej nxansave zogj kangëtor tjerë dhe kështu dalin, qyqja, mulleja, parosi bengu, fuga etj. Gjith ato që u biseduën për bilbilin fliten dhe mbi çdo njanën veç e veç por tu i krahasue me zogun e njoftun. Në funt fare nxiret kafazi me bilbilin dhe lihet përpara nxansave për një kohë dhe lihen nxansit të tregojnë ato që shofin.

**Shënim:** Gjithë fjalët e zgjedhuna që nxiren në funt të çdo pike të dispozicionit shkruhen si tekst prej mësuesit në dërrasë dhe prej nxansave në një radhue që është apostafat për këtë punë.

Milto Nano '37.

## Provë mësimi

Dhanë në klasën e V të t' Ushtrimores  
më 7. IV. 1937.

**Landa:** Dituni Natyre

**Thema:** Të ramunit e trupave.

**Dispozicion:**

1) Kallxim i Newtonit me kokrën e mollës.

- 2) (Atraksioni) fuqija tërheqëse
- 3) Pse nuk bien të gjithë trupat?
- 4) Ndryshimi i të ramit si mbas peshës e vëllimit?
- 5) Fuqija e të ramit të trupave shtohet si mbas naltësisë?
- 6) Përfitimi nga kjo?

### Zhvillim.

Mës. mbassi mbaron së këqyruri pas-tërtin bie klasën në qetësi, ban një hyrje të vulltshme në mësim në mënyrë që mësimi të bëhet intuitiv.

**Hyrje:** Mës. dëgjoni një dijetar Engles i qujtun Newton në një mbramje të bukur, tue ndënj nën një mollë afër shtëpis së vet, pa një kokër mollë të këputet prej së nalti dhe i bie aty afër e bën një gropë të vogël. Kjo gjë i tërhoqi vrejten këtij dijetarit; ky tue ndënjur aty pa edhe Hanën një tjerë, dhe si dijetar po mendonte po Hana pse nuk po bie poshtë. Tue menduar tepër kuptoi se edhe këto kanë fuqi tërheqëse (për ta provuar pse Hana, Dielli, Yjt, nuk bien poshtë, mori dy djem si juve në një moshë me një fuqi të tërhiqshin një pesh prej 10 kgr; pesha qëndronte në vënt; ktu tregoi se nga fuqia e përbashkët e tyne s'e heqin njëra jetrën.

Mës. (mer një gur) ta lëshojmë këtë prej dore çdo ngajë? Nx. ai do të bjerë në shesh. Mës. pse ra në sheshit guri? Nx. tue ndihmue prej mësuesit, përgjegjen: prej fuqis tërheqëse të tokës. Mës, ne sot do flasim mbi të ramunit e trupave. Mës. pra kur hedhim një send përpjet pse bie poshtë? Nx. ai bie se e thith fuqia tërheqëse e tokës. **Fuqija tërheqëse e tokës** (shkruhet në dërasë) Mës. a vetëm dheu ka fuqi tërheqëse? Nx. përgj. se edhe hyjt e tjerë kanë fuqi tërheqëse si Hana, Marsi, Mërkuri etj.

### Fuqija tërheqëse e përbashkët.

Tani Mës. për të provuar kundërshtimin e ajrit në tokë merr një gozhdë dhe një copë letër dhe i lëshon të dyja së bashku nx. shofin se kush bie ma përpara. Mës. kush ra ma përpara? nx. ma përpara ra gozhda. Mës. pse thoni ju ra më përpara gozhda? Nx. ra ma përpara se është ma e randë: Mës. po letra pse ra ma

von? Nx. letra ra ma vonë se ka vëllimin ma të math dhe asht ma e leht. Mës. mir kjo q' asht ma e leht dhe ka vëllimin të math, kush e kundërshton të bjerë von? Nx. këte e kundërshton ajri. **Trupat kur bien posht i kundërshton ajri:** Mës. pse trupat nuk bien një herësh? Nx. nuk i lën kundërshtimi i ajrit. Mës: si kur molla ti binte **Newtonit** në kokë çdo pësonte ky? Nx. do ta vriste: (për të provue se kur të vrasim trupat ma fort, mësuesi nxier një **axanës** përpara klasës) i thot hap dorën, dhe i lëshon një gur të vogël; herën e dyt e ngrë dorën ma nalt dhe i lëshon prap gurin, tash e pyet se kur të vrau më shum?nx. kur ngrija dorën nalt më vrau ma tepër)mës. drejtohet klasës kur bien ma me forcë trupat? Nx. kur jan shumë nalt bien ma me forcë, në këtë mësuesi u bie si shëmbëll breshërin tue thanë se breshëri ka kokër të vogël, po me qenë se bie prej një naltësie të madhe ka forcë shumë dhe i prish bimat (misër, duhan, lule, etj.) mës. po të hypim në bango dhe ti biem çdo pësojnë? Nx. do të vriteni fare pak. Mës. po si kur të biem nga minarja e xhamis? Nx. do të pëlcasim, do vdesim.

**Trupat sa ma nalt të jenë aq ma me forcë bien për dhe.** (shkruhet në dëras.)

Mës. ç'gjia munt të përfitojmë ne, nga kjo provë e trupave që bien së nalti? Nx. ne nga këta trupa përfitojmë si: mullirin e drithit, maqinat. Mës. pra kur asht një mulli me ujë pak si do ti bahet lugu? Nx. lugun duhet ta ket të gjat se atë here uji do bjerë me shumë forcë. Mës. po kur kemi uj shumë si e bëjnë lugun? Nx. atë here lugun do ta bajnë ma të shkurtën. Mës. kur ngulim kunja (hunjë) me se i ngulim? Nx. i ngulim me sopat se i biem me forcë: (kështu mësuesi vepron edhe për hunjët që ngulim në lumenj për urat).

**Prej kësaj cilsie të trupave kemi fitue:** Mullit e drithit, dërstilat, maqinat, të ngulunit e hunjve, pendylat.

Tani mës. do të tregojë se çë rugë ndjekin trupat kur bien teposhtë, mer një plump të lidhun me pe dhe e lëshon në një bardhak me ujë për të treguar rugën ma të shkurtën (ose një plump ustai në

një fije e lëshon në dërasën e zezë) më. si bien trupat? Nx. trupat bien kulmas, më. Çrugë ndjekin? Nx. ndjekin rugën ma të shkurtën.

Trupat kur bienë për së nalti ndjekin udhën kulmore, më. po kur hedhim një gur si bie? kur hedhim një gur bie pjertas, pastaj në tokë. Mës. pse bie në tokë? Nx. pse e heq fuqija tërheqëse, fuqija thithëse, e tokës. Mës. mer një copë hekur dhe një copë letër, kush të vret më shumë? Nx. hekuri të vret më shumë. Mës. mendoni pse hekuri të vret ma shumë? Nx. pse ai asht ma i randë. Mës. u spjegon se hekuri i ka thërrimet ma të dëndura dhe ma të vogla, kur se letra i ka ma të mëdhaja.

**Trupat me thërrime të dëndura janë ma të randa se trupat e çdëndur:**

Këtu mësuesi u tregon edhe një magnet që tërheq trupat duke bërë provën më të se për veç tokës kemi edhe trupa që kanë fuqi tërheqëse.

**Përmbi.** Mës. pse bien trupat në tokë? Nx. trupat në tokë bien se i heq fuqija tërheqëse e tokës. Mës. kush do na kallzojë punën e atij dijetarit. Nx. kallzojnë tue nxitur prej mësuesit deri sa të kallxohet. Mës. vetëm dheu ka fuqitërheqëse? Nx. tregojnë, hyjt, Hana, magnetin, Dielli të gjitha këto

kan fuqi tërheqëse. Mës. cili trup ra më përpara në tokë? nx. gozhda ra më përpara? Mës. çfarë gjaje i kundërshton trupat që nuk bien shpejt? nx. trupat që nuk bien shpejt i kundërshton ajri: më. kur kanë fuqi të madhe trupat? nx. trupat kanë fuqi të madhe kur janë nalt. Mës. kur të vret ma fort? Nx. . . . Mës. çfarë fitimi kemi nga kjo e ranme e nalt? Nx. Nga kjo e ranme kemi fitim : në mullinj, dër-stila, maqina etj. Mës. ç'farë rugë marrin trupat. Nx. trupat marrin rugën e drejtë.

### Tabella e orës I-rë

**Të ramit e trupave shkaktohet:**

1. Fuqija tërheqëse e tokës.
2. " " e përbashkët.
3. Ç' do trup që hidhet prej së nalti do bjerë poshtë.
4. Kundërshtimi i ajrit nuk i lën trupat të bien menjëherë në tokë.
5. Trupat sa ma nalt të lëshohen aq ma me forcë bien në tokë.
6. Prej kësaj përfitojmë: mullinj të ujit, dërstilat, maqinat.
7. Trupat kur bien prej së nalti ndjekin rugën kulmore.
8. Trupat e dëndun janë ma të randë se trupat e çdëndur.

Rustem Sino '37.

## Ditari i një Arësimtari

### Një vit shkollë.

30 Shtator — Mbarova Stazhin: jam mësues definitiv. Një mbresë të çuditëshme, që e ndaj vetëm me shkollën, ndiej kur hyj në këte banesë që është vetëm imja. Jam zot këtu por po më duket një barrë e rëndë. Kaloja nga qyteti në katund edhe jam krejt i mahnitur nga qetësia që mbretëron rreth meje. Lësh me hidhërim Drejtorin t' im. që u-tregua kundrejt meje kaqë i mirë dhe si atë, dhe nxënësit e shokët e mi, me të cilët kam kaluar kaq shumë mbremje të këndëshme. Nuk qeshë aq i dashur me nxënësit mbassi kaloja në klasë të ndryshme ku ata ishin kaqë të shumtë sa memzi i njihja

Këtu do të jem vetëm, përgjegjës për çdo gjë e për të gjithë; i ngarkuar me një kopë të vogël që nuk do njohë tjetër veç meje dhe që nuk do të dijë tjetër veçse ato që do t' i mësoj unë. Kam frikë nga këta fshatarë të vegjël që m' u-dukën të mbyllur dhe të papastër; kam frikë nga prindërit e tyre pamja e të cilëvevet është e ftohtë dhe indiferente; kam frikë nga këto mbremje të gjata të dimërit në vetmi, nga këto të diela të gjata dhe nga të ënjitet verore ku do të humbas në mendime vetëm. Do të kem librat e mija; këta do t' jenë miqt e mi. Sapo i radhita në raftet; nuk

kujtoja se do të kishja kaqë. Ja librat e mija të vjetra të punës, ja disa klasikë që m'i dhanë kur dolla nga shkolla, pak poezi, pak histori. Kurrë nuk i kishja shikuar me kaqë qef. Do t'i pyes, do të më përgjigjen, do t'jem i vetëm.

**I Tetor.** — Sot bëra mësimin e parë; kishja edhe pak nxënës, por nuk u hidhërova, munda t'i shoh së afërmi, të bisedoj me ta; janë të ndruajtur, trubullohen nga pyetjet e para, por munda t'i vë në vijë. Kanë zgjuarsi, vullnet të mirë; fytyrat e tyre fisnike ndrisin kur ndëgjojnë gjëra që i interesojnë. U bëra mësim pa e kuptuar ata dhe, kur u thash sonte: "neser „, u përgjigjen të gjithë me gëzim: "Oh si urdhëron zoti mësues „! Kishja frikë nga ky fillim: ja tek shkoj dhe shkoj mirë. Shetita për shumë kohë vetëm gjerë s'erdhi nata dhe kishja para syshë ato figura të mira fëmijsh, ata sy të gjallë dhe kërkësorë që m'ishin dukur të këqij së largu. Nuk më trembin më dhe nuk më durohet gjersa të vijë mëngjesi.

**I Nentor.** — Shkoj më tepër se një muaj që kurse kam ardhur; më ngjan sikur kam qenë këtu gjithënjë; u mësova, nuk jam mërzitur aspak. M'u-desh të rregulloja dhomën t'ime, shkollën dhe kopshtin; lava, fërkoja, fshiva dhe rrëmiha. Kanë të drejtë ata që thonë se asnjë punë s'është e ulët. Mburrem se di të përdor fshesën dhe kazmën. Prandaj çdo gjë është e pastërtë rreth meje, çdo gjë është në rregull; s'ka më pluhur, as cerga merimange, as xhame të ndyta, as barëra të këqija në kopsht. Gjërata kanë një pamje të mirë dhe më duket se vlej më shumë tashti. Klasën sidomos më pëlqen ta mbaj në një gjëndje të mirë. Në mëngjes, para se të vijnë fëmijët, shkoj kudo fshesën, furcën, fshungjerin, vendos çdo gjë në vendin e 'saj; nuk do t'ia besojta asnjëit këtë kujdes. Dua që, duke hyrë, fëmijët të gjejnë një dhomë të ndriçuar, gazmore, të ndrequr mirë, të paqme, mbushur me ajr të pastërt e që i shtyn me një herë të vihen në harmoni me ç' i rrethon. E kuptoj që kjo vepron mjaft mbi ta: i lajmë duart më shpesh, tregojnë më tepër kujdes për robat e tyre, nuk zihen më kur hyjnë dhe, kur vijnë, më thonë "mir mën-

gjes! „ me fisnikëri. Edhe fshesa edhe fshirsja janë të pastërta. Si është shtëpiaja janë dhe ata që rijnë brënda.

**I Dhjetor.** — Së vete po më shtohet dashuria për shkollën ku bëhen përparime të vërteta. Vështirsija më e madhe që takoj është t'i vë në punë njëkohësisht këta fëmij me moshë të ndryshme. Ja dal duke bërë interesante punën e tyre; kur unë mësoj disa, të tjerët shkruajnë; të mëdhenjëit zgjidhin dhe bëjnë problema dhe hartime kur jam unë pranë të vegjëlvet. E kuptoj se më e rëndësishmja është t'u fusim shijë për ate që do të bëjnë; t'i ruajmë nga detyrat monotone dhe të mërzitëshme. Shkolla duhet të jetë si jeta, të kuptohet dobija e punës, t'i ndihet nevoja, t'i vihemi asaj të shtyjtur hem nga shprehija e hem nga kënaqësia.

Duke dashur t'u jap fëmijvet të mij disa njohëni të shkencave fizike, m'u kujtua me një herë një kuti veglash, që kishja marrë nga shkolla Normale pa qef. Profesori i ynë na kishte mësuar të bëjmë vet, më pak shpenzime, me shishe me tapa, me tel, me gatarina disa vegla të mbyllura në një kuti të cilën e kishim punuar vetë. Më dukesh si një mundim i kotë. Kutinë e kishja lënë në një qoshe këto dy vjetët e fundit; nuk e dij për se e mora me plaçkat e mija; sa gëzohem tashti që e kam! S'është shërbime më pruri! Në eksperiencat e mija nxënësit hapin zytë; i bëj që të marrin pjesë edhe ata: ky është një gëzim për ata dhe një nxitës energjik. Këto prova të thjeshta më kanë ndihmuar të çkul sa e sa lajthime e besime të kota! Ojeta me një gëzim të math, disa modele që bënim punë dore në shkollën Normale. Atëhere nuk iua dija dobinë. Më kan shërbyer si modele vizatimi, prandaj do të bëj edhe të tjera. S'ndryshim i math midis studimit mbas natyrës dhe atij mbas një kopje të thjeshtë vizatimi të bërë gati që më përpara. Na stërvitemi së bashku, përpiqemi të vizatojmë të hyrat dhe të dalat, dritën edhe hijen. Shpesh herë ato nuk i ngajnë objektit dhe janë qesharake; po syri mprehet, dora bëhet më e shkathët: është një mësim i gjallë. Asgjë s'më kënaq kaq sa kur shof djemt e mi të vegjël të mbyllin sytë për

gjysëm, t'anojnë kokën, të shikojnë rradhë mbas rradhë modelin dhe punën e 'tyre, të buzëqeshin kur ia qëllojnë, të fshijnë dhe të rifillojnë. Nuk do t'i bëj një Michel Angelo, por djem vrejtes dhe të shkathët. Kaqë më mjafton. U kënaqen kur u vura mbi tryezë një pluar, është i vështirë, por është një send i njohur. Duhet që çdo gjë që mësojnë në shkollë t'a lidhin ngushtë me jetën e 'tyre të përditëshme, mbasi unë i mësoj që të dinë të rrojnë.

**1 Janar.** — Trembësha nga vetmija e mbrëmjevet të gjata të dimërit. Sà gënje-hesha! Tani vetmija m'ua bë një shoqe. Plot zbulime kam bërë në dritën e llambës s'ime. Fillova të rikëndoj ose më mirë të këndoj klasikët t'anë. Kujtoja se i dija Nuk kisha parë asgjë në 'ta. Racine-i<sup>1)</sup> më ka mbushur me admiratë; nuk e lëshoj nga duart. "Andromaka", dhe "Ifigjenija", nuk më lënë vetëm. Tjatër është të bësh gati një provim, tjatër është të këndosh për vehte, pas qefit, pà tjatër merak veçe të kuptuarit dhe të shijuarit. Sa forcë e madhëri tek "Britanicus", ç'farë ëmbëlsi n'Esther, ç'madhëri te Atalia. I kishja këta thesarë në dhomën t'ime, nën dorën t'ime edhe të sigurtë. Po të mos mendonja do

<sup>1)</sup> Racine-i (1639 — 1699) Tragjedian i math Freng. Shkroi fragjedit: "Andromaka", "Britanicus, Fedre, Atali, Esther etj. e një komedi "Les plaideurs".

të rija gjith natën me 'ta; por më duhet të ngrihem shpejt që të kem kohë për të korregjuar defterët dhe për të bërë gati mësimet. Është e vërtetë se duke lëçitur këto libra bëj një farë gati të cilës i ndiej efektin. I shoh gjërat më këthjellët, kam zëmërën më të nxehtë dhe kam më tepër gjallëri në punët.

**1 Shkurt.** — Sà më tepër kalon dimëri aq më shumë më pëlqejnë këndimet. U mendova një herë t'i hyjë a po jo "Cornille-it; fillova nga ato pjesë që kujtoja se dija më mirë: "Cid e Horaces"; vijova dhe të tjerat. Është një botë e tërë. E kuptoj se do të më duhet t'a këndoj edhe disa herë sepse nuk thellohesh kaq lehtë në një gjeni të tillë me një këndim goftë ky edhe i ngadalshëm e i kujdesshëm. Më çudit, më trubullon, më jep ambicje heroizmi. Dhoma e ime zgjerohet, madhërohet. . . . Jo, sigurisht, në këte dhomë nuk do të ketë vend mërzitja. Mbas këtyre librave, këndoj të tjera të cilat kuxova t'i marr në duart; ja një volum i Pascalis-it, një tjetër e Bruyere, kam pak nga Victor Hugo-si, copa të zgjedhura, disa libra të Michelet, një të vjetër La Fontaine e pastaj tërë Moliërin. Le të bjerë dëborë sa të dojë, unë kam bukë në raft.

Fundi në numërin që vjen

E përktheu nga Frëngjishtja  
"Normalisti"

## RABINDRENAT TAGOR

Nga libri i 'tij "Hëna,

### Trashëgimi

Nga erdha unë ?

Ti ku më gjete ?

Foshnja, kështu e pyeti nënën e vet.

Ajo, me një zë gjysëm të vajtur, i përgjegjesh fëmij, duke e shtërnguar në gjirin e sajë.

I dashur! Në zëmërën t'ime, ti ishje malli i jetës s'ime . . . ishje kuklla e ëndruar e lodrave të mija të foshnjerisë. . . Në gjirin e madhësis së shtëpis s' onë ishje i mëshehur. Unë të dëshirova dhe Zoti të krijoi.

Ti jetove në zëmërën t'ime e të nënës s'ime . . . Në të gjitha dashuritë e mija dhe në të gjitha shpresat e mija, ti ke pasur vendin e rezervuar. Në gjirin e shpirtit të shejtë të shtëpis s'onë, u ushqeve me qenjen e njerzisë.

Në çupërinë t'ime, kur gjethet e para të luleve të zëmërës s'ime dalë nga dalë u hapën, ti ishje flutura e ernavet të atyre luleve të mija të para.

Si rët e pruarua dhe të skuqura nga rezet e diellit, në dejt e mija u lulzua shija e embël e qenjes t'ënde. Ti, duke notuar në gjithësinë e jetës, si një engjëll i dashur i Perëndisë, erdhe në botë.

Sepse fytyra e yte i ngjan të të tjerave, këte nuk e kuptonj.

Ti je e emja, foshnje! Ty të shtrëngoj në gjirin t' im, nga frika që mos të të humbas. Cila magjistare më fali thesarin e paçmuar të botës dhe ma futi ate në krahet e mija?

**BURIMI**

Kush din se nga vjen gjumi dërmojnës në sytë e vockla të foshnjes?

Ashtu thonë se gjumi qëndron në fshatin e hurivet, atje nën hijen e pyjevet, pranë dy burbuqeve të zemruara dhe të rrethuara me xixillonja; atje pranë rrin gjumi dhe këtej vjen për të puthur sytë e foshnjes.

— Po ajo buzëqeshja e ëmbël e foshnjes në gjum, ku ka lindur?

Ashtu tregojnë se buzëqeshja ka lindur në rezet e arta të hënës së rritur dhe, duke u kapur në rëet e nxituara të vjeshtës, për herë të parë është çfaqur në ëndrën e një mëngjesi pa brymë, për të lëvizur në buzët e foshnjes që flë.

E p e r k t h e u  
Sadi pejani

**Varfanjaku**

—I—

Po fryn era dredharake  
Erdhi dimri pak nga pak,  
Erdhi stina zëmërake  
Për të mjerin varfanjak.

—II—

Era fryn, ai zu dridhet  
Nëpër rrugat pa njeri,  
Zu bën ftoht, ai po mblidhet  
Nëpër rrekat plot stoli.

—III—

Erdhi dreka. s'ka ç'të hajë,  
Asnjë dorë s'ë gostiti;  
Po vjen nata, nga t'ia mbajë?  
Kudo vate, kush s'ë priti.

—IV—

Fare nat'ë errësirë!  
Po fryn era pa pushuar,  
Më bark zbrazët, trup të ngrirë  
Po vajtoi i pikëlluar!

—V—

Kërkon buk'ë kush s'i gjegjet  
Kërkon strëh' e në shesh dergjet,  
Kërkon zjarr' e dimri ngrirë  
Po e vdes me të pa hirë.

—VI—

Edhe bora mbi të tjera...  
Pse, s'harriji shiu e era?  
Dhe ajo filloi të bjerë  
Mbi atë, jo mbi të tjerë?

—VII—

Varfanjaku, sysh lotuar  
Dridhet, tundet, si një fletë,  
Dhe rënkon me zë të shuar.  
Pse e sheh, që s'ka më jetë.

—VIII—

S'po pushon e shkreta borë!  
Ia mbulojti këmb' e dorë;  
Dal nga dal e mbuloi tërë.  
Ah i shkretil ç'pati bërë?

—IX—

Bije borë! errësirë,  
Ç'po fryn era pa pushuar,  
Erdhi dimri ftoht'i ngrirë  
Kalon nata pikëlluar

Janar 1937 **Neim Babameto**

**Mbi vorr të nanës!**

I

Atje n' Shkodër, n'atë fushë t' Rmajit  
Eshtnat e nanës s' ime pushojnë,  
Si për t' dasht'nën shpesh herë lot-vajit  
Qi vesë m' kullojnë.

II

Atje n' atë lendinë, ku kandshëm era  
Përmbi të vdekun fryn me mallëngjim;  
Atje n' nji vorr asht nana ime, e mjerë  
Qi më la jetim!

III

Atje ku qyqja këndon pa—ja—dà  
Disa kangë—vaji t' veshuna në zi;  
Atje u-gjeta shpesh herë tue që  
Qysh në vocërri.

IV

Por sot, un' i ngrati larg Shkodrës jam  
Tu' dnesë, tu' dihatë, i mbushun me vnrë  
Për at vorr të dashtun, qi vajtue shum kam  
T' a shof dhe' i herë.

V

Dallëndyshë shtëgtare, shpend i bekuem  
Kah fusha e Rmajit për muë t' kalosh!  
Përmbi vorr t' nanës s' ime, pa pushuem  
Për muë t' vajtosh!  
Ndoc Fishta '35

# Nëpër Revistat

Na u duk interesant të shënojmë këtë radhë rëndësinë që revista amerikane "ACHILD STUDY", jep korespondencës së sajë me prindë e me mësuesit dhe të tregojmë shpirtin e bashkëpunimit që shvillohet me një besim të plotë midis tyre. Do të na mjaftojë të përkthejmë këtu një pyetje të bërë prej prindëvet dhe një tjetër të bërë prej një mësuesi dhe përgjigjet e revistës. Në këto përgjigje çuditësh me "bon sens" — in përvojën, vërejtjen e hollë dhe të drejtë dhe liberalizimën e plotë për të respektuar lirin e tjetrit.

**Pyetja e parë.**— Mbesa e ime sa po mbushi 3 vjet, çupë e vetme, e frikëshme, gjithënjë futet në fustanin t' im kur ka njeri të huaj. Për të pakësuar këtë të ndrojtur e regjistrova në një shkollë foshnjore po pa sukses. Ajo qan çdo mëngjes kur ndahet prej meje dhe kur është atje më të shumtën e kohës luan fare vetëm.

A duhet të ngulë këmbë? Deri në ç' pikë shkolla munt të më ndihmojë për të zbutur të voglën t' ime t' egër?

**Përgjigje.**— Të shkuarit pas këtyre fëmijëve të kësaj moshe dhe marrëdhënjet me ta na duken të kenë një rëndësi të tillë që dhe për një bebe si e juaja duhet t' armatosi me durim në këtë provë të parë. Mbassi ajo është çupë e vetme e mësuar për këtë shkak të rijë nën mbrojtjen e personave të mëdhenj, të voglës i vjen keq të ndahet nga kjo mbrojtje e nxehtë për t' u bërë një njësi në një grup. Por kjo është një nevojë që shpejt a vonë duhet përballur. Lëri kohë të mësohet, provoni dhe disa herë. Folini për këtë vështirësi mësueses së saj.

Kini provuar ta përcillni në shkollë me ndonjë njeri tjetër? Do t' ju porositnja gjithashtu të ftoni në shtëpi t' uaj dy ose tre fëmijë, në mënyrë që ajo t' i njohë familjarisht reth vatrës. Po më tepër përpiquni

ju vetë që të mos tregoni shumë ankth dhe shqetsim gjë që do ta mallëngjente më tepër çupën dhe do ta bënte më të vështirë të ndarët t' uaj prej saj. A jini të sigurtë sinqerish! se ju doni q' ajo të jetë e lumtur lark jush? Nuk ju kërkohet të jini spartiane.

Ka fëmijë tre vjetësh që janë fizikisht ose nga nervat shumë të rinj për të shkuar një jetë së bashku në shoqëri. Përgjo shënjat e lodhjes e të përpjekjes së saj. Pas një radhë provash serioze, në qoftë se fëmija duket të mos mësohet, prisni dhe pak kohë. Por në shtëpi përfitonin nga kjo kohë për t' i shvilluar shpirtin e pavarësisë e të vet-veprimi duke e bërë të luajë me të tjerë fëmijë dhe duke e lënë në dorë të njërësve të tjerë kohë mbas kohe.

**Pyetja e dytë.**— Kam një klasë me fëmij 7 vjeç, djem e çupa, në një shkollë të vogël fshati, në një rreth pak prapanik. Gjithë fëmijët e kësaj moshe interesohen për kafshët dhe çdo vit ne u japim mjaft kohë kafshëve shtëpijake. Natyrisht fëmijët bëjnë pyetje për të vegjëlit e kafshëve, për origjinën e tyre, për lindjen; e këtë vit si përgjigje të kaq pyetjeve unë u këndova librin Growing up të Karl Schweinitz qi i thotë çiltas dhe thjeshtë misteret e jetës. Po nga kjo gjë mora një rrebesh protestimesh nga mëmat e fëmijëve.

A mundeni të më tregoni si do të duhesh ta përkujta këtë çeshtje?

**Përgjigje.**— Konfliktet për sa i përket shkollës dhe familjes janë të shpeshë dhe delikate. Juve ky këndim, që u kini bërë nxënësve, u është dukur i drejtë, i natyreshëm e i nevojshëm, po mëmavet që janë rritur në një rreth, ku çdo çëmë (allusion) për prodhimin, e sidomos në mes të djemve e çupave, duket jo vetëm pa vënd por dhe i pa moral, një këndim i tillë u duket si i keq, shkatërronjës dhe krejtë pa vënt.

Edhe në qoftë se nuk jini të një mendimi me prindët për sa i përket kësaj çështje, detyra e juaj është që t'i respektoni.

Me qenë se e njihni rrethin t' uaj më duket e nevojshme, të bëni një mbledhje të nënave të nxënësve t' uaj në fillim të vitit dhe t' u paraqitni këtë vështirësi.

Në qoftë, se mbas një kuvendimi të sinqertë dhe të plotë shumica e prindërve të gjykojnë që, sado që e njohin nevojën të mësohen fëmijët mbi gjëra seksuale, ka rreziqe të jepen këto hollësi në klasë botërisht, në e çmojmë dhe na duket me rëndësi që ta mbash e ta ruanç këtë dëshirë të prindërve dhe të çkarkohesh këtej e tutje nga çdo punë e tepërt në këtë fushë.



Në revistën Hygienike: "Le corps et l'esprit", në mes të shumë këshillave të mira hygienike për të na nxitur që të rrojmë më mirë, M. de Vaux Philipau na kallxon me një premi shumë tërheqëse një shërim të papandehur.

Në qoftë se procedimi s' është në dorë të kujtdo, me gjithë atë tregon se sa trupi i shtrohet të dashurit (vullnetit).

Gavril Vesselitsky Bojdarovitch prej origjine Herzegovinase, po që familja i ishte berë Ruse prej shumë kohësh, banonte në

Paris.

Ishte aty nga viti 1875, kur Turqit dhe një herë masakruan të krishterët e Herzegovinës dhe grat e fëmijët iknin nëpër male ose në Dalmati në rrezik që të vdiqnin nga uria. Mbassi humbi shpresat për t' arritur qëllime politika Gavril Vesselitsky çonte një jetë të papunë në Paris, ku i u- prish dhe shëndeti dhe doktorët humbën shpresat që ta shpëtonin. Gavrilli, i sëmurë, këndon në një gazetë fatin e tmerrshëm të bashkë atdhetarve, të fatkëqijve t' arratisur Herzegovinas, dhe vendos me një herë që të vejë t' u ndihmojë.

Në frikën më të madhe të doktorëve të 'tij miset për Vjenë, pastaj shkon në Petrograd, vepron pranë gjithë kryeqyteteve t' Evropës, themelon një komitet ndihmash, mbleth fonde të shumta, vete vetë në vënt për t'organizuar turmat e shpërndara të Herzegovinasve, krijon vatra e shkolla, me një fjalë shpëton nga mjerimi fizik e moral me mijra fëmij, shpenzon po thuat gjithë pasurinë e rifiton shëndetin.

Kështu pra një goditje morale që më veprimtare se gjithë mjekimet. I lënë më nj' anë prej mjekëve më 1875. Gavril Vesselitsky vdiq qelësisht nga pleqëria më 1930.

## Randësija e kopshtit shkolluer.

Vlera e kopshtit në edukatë ka qenë e njoftun qysh në kohat e lashta, prej Pestalozzit, Rousseau dhe Froebelit, aq sa ky i fundit thotë se ç' do shkollë duhet të ketë pranë kopshtin e saj e të përdoret prej nxanësve. Në themel të këtij parimi, shofim se shkollat fillore të këtyne shteteve të Europës: Zveçje, Rusi, Englliter, Belgjik dhe Amerikë, kopshtet shkollore janë një pjesë aktive dhe me shumë randësi e programës së sotshme; veçanërisht edukatorët Amerikanë dhe Englezë kanë mbrijtë me pasë përfundime të shkëlqyshme në stërvitjen e vet-vepimit të nxanësve të shkollës fillore. Edhe shteti ynë në Dekret

— Ligjen organike dhe në nenin 73 e parashef të domosdoshme krijimin e këtyne kopshteve më shumë randësi.

Shtetet e përmendun të vjetër si Roma dhe Athina i kanë pasë të përsosun kopshtet publike të cilat cilsohen për bukurinë e famshme të asaj kohe, e mjafton të përmendet në Babilonë kopshti i pezulluem në ajër. Shteti ynë, si mbas natyrës gjeologjike, klimatike karakterizohet si një vend ideal buqësuer dhe e dij m fare mirë se lumtunija e lojën do të vij vetëm prej sajë, por mjerisht janë të pakët ata, që duen të quhen bujq e prandaj për të ndryshue këte mentalitet të damshëm, duhen të me-

rren masa dhe të mbështeten shpresë të mëdha në rregullimin dhe krijimin e kopshteve shkollore. Kopshti shkolluer asht shumë i nevojshëm për shkollat fillore, për arsye se luen një rol kryesor në edukatë të fëmijvet, si p. sh: nxanësit me anën e punimeve praktike janë fizikisht të shëndetshëm, marin përfitime morale dhe lehtësohet zhvillimi e kuptimi i mësimeve të natyrës, cilsina këto, qi ndërhyjnë drejt në karakter dhe e ndihmojnë nxanësin në jetën praktike. Përveç kësaj nxanësit me anën e punës në kopsht familiarizohen në punime, kujdesime e në bukurit e natyrës. Në anën tjetër njeriu si konsumues i përditshëm i perimeve të ndryshme, mund të themi pa lajthim se mvaret në këto ushqime të pasuna dhe të nevojshme për trupin t'onë. Kopshti shkolluer në ditët t'onë përdoret edhe në shkollat e mesme dhe të natës duke pas përfitime në mësimit e fizikës, Chemistris dhe Botanikes. Në kopshtin shkolluer randësija a barra ma e madhe i bjen mësuesit, i cili duhet të jetë i përpiket, puntor, energjik, i zoti dhe i qeshun; nuk themi qi ky të jet i mbaruem krejt, por mjafton qi të jetë ( pari passu ) mësues i veches në bashkpunim me nxanësit. Mësuesi i kujdeshën, punimet e kopshtit i rregullon në bazë të një plani të rregullt, si: punë praktike në periudhën e stinve të Vjeshtës. Dimër, Prandver dhe Ver gjatë vitit shkolluer, përpjestimi i tokës ç' do klase a grupi, caktimi i bimve të mbjelluna në pjesë. Nxanësit në moshë të vogël duhen caktue në punim e kujdesime të lehta si ndër lule, kurse ma të rritshmit, në punra pak ma të randa. Sa për sipërfaqen toksore të kopshtit ky mund të jetë si mbas vendit ku ndodhet shkolla tue fillue prej një pjese të vogël e deri në 4-6 dylm tokë.

Të zgjedhunit e vendit për kopsht: Në të zgjedhunit e vendit për kopsht këshillohet qi të gjindet një vend i përshtatshëm duke pasë kondita të cilat po i rreshtojm: Toka të jet e drejtue me kah jugu ose jugë-lindja, të jet afër shkollës, të

ketë ujë të mjaftueshëm, të ajrohet mirë të ketë dritë, të jetë e mbrojtun prej ernave të forta te veriut e të lindjes, të jet tokë e pasun.

Plani i kopshtit: Në krijimin e kopshtit shkolluer plani mund të jetë në forma të ndryshme dhe të ndar në pjesë, si mbas madhësis së tokës qi asht destinue për këte qëllim.

Pjesa e I caktohet për mbjellje lulesh, e II për perime të ndryshme, e III për jatak të nxehtë, e IV për pemë frytore dhe e V shërben si fushë provimtare.

Kullimi i kopshtit: Një randësi e madhe në kopsht i duhet dhanë kullimit të ujit të tepërt, me anën e hendeqeve dhe të vijave.

Thurja e kopshtit: Asht e domosdoshme qi kopshti të thurret për me garth ose me tel të posaçëm, në mënyre qi të mos damtohet prej shtazëve të ndryshme.

Veglat e punimit: Shkolla duhet të ketë një sasi vegla punimi si: Bela, Kazma lopata, zheten, karo, tezga dhe Sershan të ndryshme. Sasija e këtyne mund të jetë si mbas nevojës dhe për rajtjen e këtyne duhet të ketë një vend të posaçëm, ku të mbahen mirë, pastër dhe me kujdes prej nxanësve dhe, në asht e mundun, çdo nxanës duhet të ketë vendin e tij të veçantë.

Rregullimi i punës: Në kohën e punimeve praktike nxanësit duhet të mësohen mos me folë, një farë disipline e lehtë dhe kah mbarimi i mësimit mblidhen nën drejtimin e mësuesit dhe përshkruajn në radhajt pikat kryesore të punës praktike të orës. Ora e mësimit duhet të jet ma tepër se 60 minuta dhe sasija e nxanësve jo ma tepër se 20.

Gjergj Shota

*Urim*  
Profesori i Gjuhës Z. Dr.  
Zjauhin Kodra u fejua. "Normalisti", i uron bashkim të shpejtë.

— LODRAT —

I çkujdesun rrin ti o foshnje, duke iuajtur tërë ditën e ditës, me ate shkopin t'ënd të thyer, në mes të pluhrave.

Unë, duke vërejtur lojën t'ënde me atë shkop të thyer, të shikoj me buzë në gas.

Unë merrem me hesapet e mija. Në çdo orë e çast bënj mbledhjen e një tok shifrave.

Ti shikon punën t'ime dhe ndofta mendon: "Përse e vdisni kohën t'uaj me këtë lojë të mërztur dhe pa kuptim?".

Foshnjë, unë kam harruar të los me shqepinj e me petulla të gatuara nga balta.

Unë kërkonj lodra të shtrënjta dhe jam duke mbledhur copra ari dhe argjendi.

Ti nga çdo send nxjerr lodra për vehte, kurse unë e vdes kohën t'ime dhe fuqinë e trupit t'im pas atyre dëshirave, që kurrë nuk do të mundem t'i gëzonj.

Me lundrën t'ime të kalbur mundohem të kalonj detin e dezideratave dhe harronj se edhe unë los me lojna, si edhe ti.

— ASTRONOMI —

Unë thashë: "Në mbrëmje, kur hëna futet në mes të degave të "Madamit,, a nuk mund të ziret?".

Vllai i math më buzëqeshi dhe më tha: "Ti je shumë i çuditshëm. Hëna është shumë larg nga neve, si mund të ziret?". Unë i thashë: "Sa i çmendur je ti, vlla! Kur nëna ulet dhe na shikjon nga dritareja e shtëpisë, edhe për ate do të thuash se është larg nga ne?".

Vllai më tha: "Ti je i shastisur! Ku do të gjejsh një lak aqë të math për të kapur hënë?".

Unë i thashë: "Jam i sigurt se ti hënë mund ta kapish me dorë,, Mirëpo vllai qeshi dhe më tha: "Ti je më i çuditshmi fëmi që kam mundur të shoh deri më sot. Sikur të afroresh hëna, do të shihnje se sa e madhe është ajo,,.

Unë i thashë: "Vlla! Sa gjëra të kota ju mësojnë në shkollën t'uaj. Kur nëna përkulet dhe kërkon të na puthi, fytyra e 'saj, nuk duket e madhe?".

Mirëpo vllai vazhdoi të më thotë: "Ti je shumë budalla,,.

E përktheu  
(Sadi Pejani)

# F o l k l o r a

## Fjalë të qëmtuara në Skrapar.

gjatë pushimeve të vitit shkollor 1935 — 1936.

**Fuckë** — ( a ) — gojë e hundë bashkë, i zë fuckën = i zë frymën.

**Cibune** — ( ja ) = gunë e shkurtër me mëngë.

**Mykë-a** = ana e kundërt e tehut.

**Fig.** Ky njeri ka vajtur në mykët, d. m. th. ky njeri është shumë plak.

**Brashnje** ( ja ) = opingë a kpuçë e vjetër e e grisur.

ai është berë brashnje, d. m. th. perdoret si të duan të tjerët.

**Xanxë** = grindje, aji u shtiri xanxë = i bëri të grinden.

**Xanxare** = grindavece, e egër, mushkë xanxare = mushkë e egër, që nuk shtrohet.

**Lënjë-a** = grindje (n'atë shtëpi është futur lënja).

**Kërthitur** = vonuar. ( Shiu në Qershor kërthin të lashtat ).

**Kuar, kojtur** = Shumë njerzve, kur udhëtojnë një rrugë të gjatë, u kuhet mishi d. m. th. u fërkohet, u-kuqet dhe shumë herë u del gjak. ( Jam kuar, kojtur ).

Kuhet mishi sidomos nën sqetull dhe në mes të gjunjëve.

**Të shkrepura** ( t ) = masati, guri i zjarrit e eshka.

**Eshkore** = kuleta, ku mbahet masati, eshka e guri i zjarrit.

**Punë-a** = qelbi i një plage — kjo plagë ka mbledhur **punë**, ka zënë **punë** d. m. th. ka qelq.

**Bot-i** ( botër-it ) = një njeri, person i panjohur pashë një bot = një njeri që s' e njihnja. Kush është? një bot.

**Vaporet** ( vetëm shumës ) puçra që dalin nga të nxehtit në verë e sidomos të vegjëlve.

**Kacitur** = lajthitur, **dhitë u kacitën**, u ndanë nga shoqet, **m' u-kacit fjala**, d. m. th. më humbi fjala, harrova fillin e fjalës.

**Tërbi-ja** = tërbim i, qënëti u thonë: u rëntë tërbija.

**Loloshe-ja** = Çakëll-a. ( Fr. Jouet )

Sjelli ndonjë loloshe fëmijës që të mos qajë.

**U gjyfqye** — u gjyfqye për të ngrënë = u përpoq u bë copë për të ngrënë.

**Puruar** = ( mburuar ) mprojtur, më puroi nga qentë, vend i puruar = vend ku i zoti ndalon të hyjnë gjëja për të kullotur — vënd me bar.

**Çërdhitur** = çthurur, çerdhis çarapen, i nxjerr fije.

**Kristë-a** = copë hekur si thikë që duhet për të kruajtur bukët e pjekura në ponicë.

**Krest-i** = krehër që përdoret për të kruajtur, krehur kuajtë.

**Qëngjore-ja** = rripë me të cilin u lidhin kafshëve samarin ( Fr. sangle ).

**Koç?** = i veshur e i mbathur koç, d. m. th. i veshur mirë.

**Koçinë** = garth që bejnë rreth pemëve të vogla për t' i mbrojtur nga kafshët.

**Çimboskë** — ( a ) = bres i hollë prej leshi me të cilin lidhim fëmijit në djep.

**Farkë-a?**,—pse je kaqi ligur? "Kështu e kam farkën", d. m. th. kështu është natyra ime

**Kofshinë** = lëkurë a rrobe që vihet në qafë të kaut që të mos e vrasë zgjedha.

**T. Reovica**

**Çullë-a**, ose **çukë-a**, i thonë deles që i mungojnë veshët.

**Kabadhë-a** = quhet ajo dhi, e cila gjysmën e trupit e ka të **kutërë** dhe gjysmën tjetër e ka të zezë.

**E kutërë** = quhet pjesa e trupit të dhis, që ka një ngjyrë gjysmë të kuqe e gjysmë të verdhë, të afërueshme si të njera ashtu edhe tek tjetra.

**Barzë-a** = **bucë-a** = **qerbë-a** = quhet ajo dhi që ka dy vilarë të kuq në të dy faqet.

**Barxhë-a** = i thonë asaj dhije që është krejt e bardhë.

**E vrizërë-a** = dhi e bardhë me dy vilarë të kuq ose të mushkër në kurris.

**Nangërë-a** = dhi krejt e zezë; i thonë edhe mëllënjë ( e përdorin në Çamëri ).

**Mazhë-a** = dele me fytyrë të zezë e trupi i bardhë.

**Sorkë a** = dele me vilarë të zes në fytyrë.

**Syskë-a** = dele me pika të zeza në fytyrë.

**Kuacë-a** = dele me fytyrë të kuqe.

**Bejkë-a** = dele krejt e bardhë.

**Çetur-i** = Enë prej druri në formë të sakanit.

**Qeft-i** = është një enë në formë të sapllakut që e përdorin për të kthyer dja-thët; i thonë edhe **polig**.

I mblodhi:

**Halim Hodo.**

## Shënimet e Redaksisë.

### Lëvizja Sportive.

Në këtë muaj shkolla e jonë ka bërë ndeshje me Gjimnazin e Shtetit të Tiranës, si këtu ashtu edhe në fushën e atijeshme. Loja e parë, që u-bë në qytetin t'onë, mori fund me një fitim të mirë (3-3) për skuad-

rën gjimnaziste. Lojtarët t'anë humbën më tepër nga mungesa e stërvitjes se sa nga mungesa e zotësisë. Kjo u-provua në "Revanche in" q' u-bë më 4 të muajit në Tiranë. Gjimnazistët, me gjithë se në fushën e tyre, nuk mundën të korin fitimin e parë! Përveç foot ballit skuadrat

e të dy shkollave u-ndeshën dhe në basket-ball dhe voley-ball.

#### Mjete mësimi

Para 20 ditësh erdhën në shkollën t'onë veglat e Fizikës dhe të Kimisë q' i pat porositur Ministria e Arsimit. Me ardhjen e këtyre u plotsua një mungesë e madhe e shkollës.

#### Konferenca

Gjatë muajit që shkoi në qytetin t'onë u-mbajtën dy konferenca në sallën e kinemas "Nacional". Njerën e dha në fillim të muajit Profesori i Historisë Z. Petraq Peppo me themën "Evolucioni gjeologjik i tokës shqiptare".

Këto ditë një tjetër konferencë u-dha nga Drejtori i shkollës s'onë Z. Aleksandër Xhuvani. Drejtori i ynë trajtoi një temë patriotike; ai foli mbi N. M. Tij dhe Famil-

jen Mbretnore. Në të dy konferencat u-ndodh një shumicë ndëgjonyes ndë të cilët çquheshin arsimtarët dhe përgjithësisht intelektualët e vëndit.

**Kursi i Olivikulturës.** Prof. Alfredo Roventini, i ftuar posaçërisht nga Ministria e E. Kombëtare, dha këtu në Elbasan një kurs të shkurtër teorik-praktik mbi Olivikulturën. Në këtë kurs muarën pjesë përveç teknikëve të ullinjëve dhe nxënësit e klasës së fundit të shkollës s'onë. Prof. Roventini u-dha maturantëve një idë mbi gjëndjen e Ullishtavet t'ona dhe mënyrën e përmirësimit të tyre. Foli përgjithësisht mbi mbjelljen, shartimin dhe plehrimin e ullinjve dhe veçanërisht trajtoi gjërë gjatë sistemin e ri të krastitjes q'ai vetë ka krijuar gjatë eksperiencës së tij një zet vjeçarë në kultivimin e Ullirit.

---

Ndreqje: Në faqen 6 shtyllë e dytë radhë e dytë pika përpara fjalës "sikurse", nuk duhet.

## Posta e Jonë.

- Z. M. Daiu — Gjenëvë. Muarmë artikullin. Do të botohet.
- Z. H. Spahiu — Peshkopi. Pjesërisht do t' i botojmë më vonë.
- Z. Pano Vasili — Përmet. Na erdhën të hollat. Ju falënderojmë. Presim dhe të tjerat. Të fala.
- Z. Qamil Skuqi — Zerqan. Muarmë. Të fala.
- Z. Ali Idrizi — Delvinë. I kemi marrë letrën dhe të hollat. Muarmë vesh sa na shkruani. Jemi të kënaqur me kaqë. Të fala.
- Z. Q. Guranjaku — Tiranë. Të hollat qi na keni dërguar i kemi marrë. Të fala.
- Z. Musa Tafa — Lushnjë. Muarmë. Shumë të fala.
- Z. S. Paparisto — Genëvë. Artikulli mbi Institutin u-radhit që të shtypesh, mirpo u-la nga shkaku i lëndës së tepërtë. Artikullin tjetër e muarmë këto ditë. Të fala.
- G. Santo — Kolonjë. I muarmë. Të fala.
- N. Burbo — Lushnjë. Shtyhet për më tutje nga mungesa e vëndit. Të fala.
- I. Shishmani — Peshkopi. Do të botohet.
- Z. E. Spahiu — Pogradec. Kemi marrë të hollat e para. Presim të tjerat. Të fala.